



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 38 regjistër (JR)
Datë 04.09.2023

Nr. 74 i vendimit
Datë 24.10.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 24.10.2025, ditën e premte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 38/2023 (JR), datë 04.09.2023, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 673, datë 15.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike, e cila kërkoi ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 673, datë 15.06.2023, dhe kërkimin në bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si dhe dëgjoi parashtrimet dhe analizoi kërkimet në bisedimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe e bisedoi atë në prezencë të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për arsye se ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin Mirela Zavalani ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), nga të cilat rezulton se:

2.1. ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Mirela Zavalani”¹, referoi se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar vlerën e pasurisë në bashkëpronësi dhe burimin e krijimit të pasurive;
- nuk ka kryer fshehje;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

2.2. DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, konstatoi *përshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit².

2.3. KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit³.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Pasi kreu hetimin administrativ, me vendimin nr. 673, datë 15.06.2023, Komisioni vendosi të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit, duke arsyetuar për secilin kriter si vijon:

3.1. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*, pavarësisht një pamjaftueshmërie financiare të konstatuar prej (-) 1.854.851 lekësh, vlerësoi se ajo i përket periudhën 2004-2006. Pas vitit 2007, kur subjekti ka marrë detyrën, pamjaftueshmëria ishte në vlerën (-) 428.356 lekë. Nën këtë logjikë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerën e mungesës së

¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 31.08.2018, me raportin e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit.

² Shkresë nr. {***} prot., datë 11.06.2021, me raporte të kontrollit të figurës, deklasifikuar plotësisht.

³ Shkresë nr. {***} prot., datë 24.03.2023, me vendimin e KLP-së për miratimin e raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

burimeve të ligjshme gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, Komisioni e vlerësoi të pamjaftueshme për të sjellë pasojë për subjektin e rivlerësimit. Në këtë rast, Komisioni nuk e gjeti të aplikueshme pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

3.2. *Për kriterin e kontrollit të figurës*, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm.

3.3. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe analizës së raportit të hartuar nga KLP-ja, Komisioni nuk konstatoi shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore dhe serioze në lidhje me drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e subjektit. Mbi këtë bazë, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit, ka ushtruar ankim Komisionerja Publike, znj. Irena Nino, e cila kërkon ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit. Shkaqet e ankimit lidhen vetëm me aspektin e vlerësimit të kriterit të pasurisë së subjektit, dhe janë si vijon.

4.1. *Për godinën e kombinuar në Patos*, subjekti ka kryer deklarime të pasakta e kontradiktore, që krijojnë pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve. Sipas Komisioneres Publike, pasaktësia krijon pamundësi për të verifikuar se cilat ndër versionet e deklaruara nga subjekti apo aktet e paraqitura prej saj, pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike *për krijimin e pasurisë, periudhën e ndërtimit, vlerën e investimit*, si dhe *ligjshmërinë e burimit* të të ardhurave të përdorura. Komisionerja Publike kërkoi që juridiksionit kontrollues të Kolegjit, përveç balancës së konstatuar prej Komisionit, t'i nënshtrohet analiza financiare e periudhës 01.01.2004 – 31.10.2007, duke u fokusuar në rishikimin e:

(i) disa zërave të analizës financiare, si llogaritjet e Komisionit mbi shpenzimet e jetesës së subjektit dhe personave të lidhur me të për vitin 2007, referuar standardit të përdorur në jurisprudencën e deritanishme bazuar në korrespondencën e ILDKPKI-së me INSTAT-in. Kjo analizë do të thellonte balancën negative të vitit;

(ii) të ardhurave të deklaruara nga *supermarketi*, për të cilat subjekti ka bërë deklarime kontradiktore. Këto të ardhura nuk e kalojnë nivelin e besueshmërisë dhe pranueshmërisë e, për pasojë, do të çonin në konkluzionin e pamjaftueshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive dhe të mbulimit të shpenzimeve të tjera.

4.2. *Për apartamentin në Tiranë*, Komisionerja Publike kërkon që t'i nënshtrohen kontrollit: (i) pasaktësitë e deklarimeve, të cilat krijojnë mospërputhje dhe paqartësi të burimit real të krijimit të pasurisë; (ii) për saktësinë e deklarimeve të subjektit për depozitën bankare [*që ishte një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie*], në vlerën 1.950.000 lekë, e krijuar nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet derdhjes së *cash-it* në datën 18.06.2004, Komisionerja Publike pretendon se një ndër burimet e krijimit, huaja që vjehri mori nga xhaxhai i subjektit, u deklarua vetëm gjatë hetimit administrativ në Komision.

4.3. *Për disa transaksione bankare të bashkëshortit* të subjektit përgjatë vitit 2009 – 2013, që arrijnë në vlerën 59.020 USD, Komisionerja Publike pretendon se subjekti nuk u pyet për

qëllimin apo burimin e shumave të transferuara. Përfshirja e tyre do të ndikonte drejtpërsëdrejti në pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme, me ndikim domethënës në analizën financiare të viteve respektive.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisionerja Publike të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

6. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

7. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Institucioni i Komisionerëve Publikë, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, u mor në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve.

7.1. Në seancën gjyqësore publike të datës 29.09.2025, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural të ankuesit, nga Komisionerja Publike te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Altin Dumani. Ky i fundit u përfaqësua në gjykim nga z. Adnan Xholi, sipas tagrave të përfaqësimit të përcaktuara në autorizimin nr. {***} prot., datë 24.09.2025.

7.2. Në parashtrimet gjatë seancës gjyqësore publike të datës 29.09.2025, në Kolegji, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi, në zbatim të kompetencave të tij në procesin e rivlerësimit, iu qëndroi të gjitha shkaqeve të parashtruara nga Komisionerja Publike, në ankim. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë të paqarta e kontradiktore në raport me aktet në dosje, duke e bërë deklarin e saj të pabesueshëm, të pasaktë, si dhe duke pamundësuar kontrollin e ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së saj e personave të lidhur me të. Ai theksoi

se shkaqet e ankimit duhet të gjejnë përgjigje gjatë vlerësimit në Kolegj, bazuar në një hetim të plotë, në analizë të saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

7.3. Në parashtrimet e saj, subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja ligjore kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Komisionit. Ato pretenduan se kërkimet e ankimit janë riinterpretim i njëanshëm dhe i pjesshëm i fakteve të hetuara dhe vlerësuara nga Komisioni. Qëndrimi i Komisioneres Publike bie ndesh me frymën dhe qëllimin e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja e saj ligjore, dhanë shpjegimet e detajuara për secilin shkak ankimi dhe kërkuar nga Kolegji çeljen e hetimit gjyqësor me qëllim marrjen në cilësinë e provës të disa akteve të reja, të cilat, sipas tyre, saktësojnë çdo rrethanë të paqartë të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe mbështesin bindshëm standardin e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në deklaram:

a) *Kontratë huaje* [nr. {***} rep., nr.{***} kol], datë 05.05.2008, me afat deri në datën 05.05.2015, lidhur nga kunati i subjektit [z. E. Z.] me kushërinj të tij [dy vëllezër S.], me objekt dhënien e një shume *deri në 30.000 USD*⁴.

b) *Dy shtojca të kontratës së huas, me data përkatësisht 31.12.2009 dhe 04.11.2010*, të lidhura midis të njëjtave palë, nëpërmjet të cilave huaja është shtuar me vlera të tjera, *20.000 USD dhe 11.500 USD*, me të njëjtat kushte dhe lëvruar në të njëjtën formë. Nëpërmjet këtyre akteve, huaja përllongaritet në vlerën 60.000 USD, e cila ka kaluar nëpërmjet llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit⁵.

c) *Deklaratë noteriale* e kunatit të saj, e datës 14.06.2025, i cili ka detajuar deklaramet rreth qëllimeve për të cilat mori huan, që lidheshin kryesisht me martesën, qiranë e shtëpisë, ndërrimin e kamionit, pagesën e shkollimit të bashkëshortes, mobilim shtëpie.

d) Pasqyra financiare të viteve 2009 dhe 2010, që i përkasin personit juridik në pronësi të kushërinjve të bashkëshortit. Në këtë pasqyrë, zëri “të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve” është në vlerën 18.932.261 lekë, në vitin 2008, periudha para huas dhe 5.932.261 lekë, në vitin 2009 [periudha raportuese]⁶. Në pasqyrën financiare të vitit 2010, zëri “të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve” nuk ka të shënuar asnjë vlerë, si për periudhën raportuese, ashtu edhe për periudhën paraardhëse. Në seksionin e huave dhe parapagimeve, në zërin “të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve” për periudhën raportuese – 2010, është shënuar vlera rreth 11.000.000 lekë.

e) Përveç sa më lart, për të mbështetur parashtrimet, subjekti ka depozituar edhe:

- (i) *aplikimin e kunatit për vendbanim* – të përkthyer;
- (ii) *një faturë për regjistrimin*;
- (iii) *një kontratë shërbimi*;
- (iv) *kontratë qiraje financiare*;
- (v) *një shtojcë rregulloreje për hapësirat e përbashkëta*;

⁴ Palët shprehen se huadhënësit do të mundësojnë krijimin e shumës nga investimet që ata kanë kryer në një person juridik [“{***}” ShPK]. Huamarrësi do ta përdorte huan për nevoja të jetesës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas kërkesës së huamarrësit, huaja do të kalojë fizikisht nëpërmjet bashkëshortit të subjektit, i cili do t'i transferonte nëpërmjet llogarive bankare të tij në favor të huamarrësit.

⁵ Kontrata noteriale dhe dy shtojcat janë vërtetime njësie me origjinalin të noterës G. B., nxjerrë nga arkiva noteriale e saj, në datën 25.01.2025.

⁶ Në seksionin e huamarrjeve të tjera afatgjata nuk ka asnjë vlerë. Në pasqyrën e fluksit monetar të vitit 2009 [dhe 2008 si periudha paraardhëse] nuk pasqyrohet ndonjë ndryshim që lidhet me detyrimet ndaj ortakëve apo pagim i dividendit.

(vi) *certifikate martese; si dhe*

(vii) *diplomë dhe listë notash të bashkëshortes së kunatit të saj.*

7.4. Për sa më lart, pasi dëgjoi palët në seancën e datës 29.09.2025, për efekt të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi të riçelë hetimin gjyqësor dhe të pranojë aktet shkresore të sipërlistuara në cilësinë e provës.

7.5. Në bisedimet përfundimtare në datën 16.10.2025, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme [z. Adnan Xholi] deklaroi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Deklarimet e subjektit janë të paqarta e të pasakta në raport me aktet në dosje, duke e bërë deklarin e saj të pabesueshëm dhe kontradiktor. Disa transaksione bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit duhen vlerësuar në kuadër të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Përfundimisht, z. Adnan Xholi kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 673, datë 15.06.2023 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

7.6. Gjatë bisedimeve përfundimtare, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e saj lidhur me ankimin, duke deklaruar se u provua ligjshmëria e burimit të krijimit të pasurisë së saj. Diferencat minimale të konstatuara nuk kanë peshë të atillë, që do të mund të cenojnë besueshmërinë e saj financiare dhe nuk lënë shkak për masën disiplinore të shkarkimit. Në vijim, përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit potencoi se shkak ankimor që referon cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë është i pambështetur në ligj dhe i rënë në dekadencë, pasi duhet të ishte paraqitur gjatë fazës së debatit gjyqësor.

7.7. Në përfundim të procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, pasi analizoi edhe aktet e administruara në cilësinë e provës në hetimin gjyqësor, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se kërkimi përfundimtar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është i bazuar. Për pasojë, vendimi i Komisionit duhet të ndryshohet. Në vijim shtjellohet arsyetimi mbi të cilin u bazua ky konkluzion.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit

B.1. Pasuria njësi shërbimi dhe ndërtesë banimi⁷ me sipërfaqe 634 m², në Patos, Fier

8. Në deklaratën *vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri, në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe prindërit e tij, të ndërtuar me kontributet familjare *para* martesës. Si burim, subjekti deklaroi të ardhurat nga puna e familjes së bashkëshortit dhe shitja e një apartamenti në pronësi më herët. Në të njëjtën deklaratë, edhe bashkëshorti e deklaroi pasurinë në fjalë të krijuar *para* martesës, në bashkëpronësi me babanë e tij, me pjesë takuese 50%. Burim krijimi janë deklaruar: (i) të ardhurat nga puna e prindërve dhe (ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm, në shumën 300.000 lekë. Po në këtë deklaratë, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar se në këtë godinë ndodhen: (i) banesa me sipërfaqe 80 m² ku ai jetoj me bashkëshorten për 6 vjet pas martese “aktualisht e pabanuar”; (ii) banesa 2+1 ku jetojnë prindërit e tij; dhe (iii) biznesi në emër të vëllait/kunatit të subjektit, i cili ka ushtruar aktivitetin si person fizik. Pjesa e fitimit nga biznesi i tij është ndarë çdo vit me marrëveshje verbale në

⁷ Tregtim pjesë këmbimi, servis auto dhe banesë me bodrum.

50% ose 40% ndërmjet atij dhe familjes së babait. Vlera e pasurisë, rivlerësuar, është 11.295.000 lekë.

8.1. Komisioni konkludoi se prindërit e bashkëshortit janë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë për një balancë negative prej (-) 4.503.237 lekësh për periudhën 1994-1998, kur subjekti nuk kishte lidhur martesë ende dhe bashkëshorti nuk punonte, si dhe as kontribuonte. Kjo balancë nuk mund t'i ngarkohet subjektit të rivlerësimit. Ndërsa për periudhën 2004 – 2006, subjekti mbetet në një balancë negative prej (-) 1.359.401 lekësh, e cila, mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, është e pamjaftueshme që të përbëjë shkak për aplikimin e pikës 3 të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.

8.2. Konkluzioni i mësipërm u bazua në shpjegimet e subjektit për kohën e ndërtimit. Kostoja e ndërtimit u bazua në vlerat e referencës së EKB-së. Raporti financiar i sjellë prej subjektit, i hartuar në vitin 2022 në kuadër të procesit të rivlerësimit, u vlerësua pa peshë provuese, pasi pasqyron vlera të ndryshme nga deklaratimet e subjektit. Nga ana tjetër, Komisioni aplikoi një kosto të reduktuar të ndërtimit kundrejt referencës së EKB-së, duke zbritur fitimin e planifikuar dhe fondin rezervë. Në analizë, u përfshinë të ardhurat nga supermarketi në formën e të ardhurave nga qiraja, si dhe dy hua të marra nga vjehri për ndërtimin e pjesës së dytë të godinës u përfshinë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara për krijimin e pasurisë, pavarësisht se bashkëshorti i subjektit i përdori ato për interesa të tij në formën e depozitave bankare. *Së fundmi*, deklaratën noteriale të datës 03.06.2023⁸ të prindërve të bashkëshortit të subjektit, depozituar pas rezultateve të hetimit, Komisioni e vlerësoi kontradiktore krahasuar me një deklaram të tyre në një deklaratë të mëparshme noteriale me datë 24.02.2020. Ndërsa në këtë të fundit, deklaruesit janë shprehur se bashkëshorti i subjektit ka kontribuar në ndërtim, në deklaratën pas rezultateve të hetimit shprehen për të kundërtën.

8.3. Komisionerja Publike pretendon se si pasojë e deklarimeve kontradiktore të subjektit, në raport me përmbajtjen e akteve të administruara, deklarimi në deklaratën *vetting* është i pasaktë dhe jo i besueshëm. Pasaktësia krijon pamundësi për të verifikuar se cilat ndër versionet e deklaruara nga subjekti apo përmbajtja e akteve të paraqitura prej saj, nuk pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike për krijimin e pasurisë, periudhën e ndërtimit, vlerën e investimit, si dhe ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të përdorura për ndërtim. Rrethanat kontradiktore në deklaratimet e subjektit dhe personave të lidhur për investimet e kryera për periudhën 2004 – 2006 duhet të analizohen në drejtim të besueshmërisë së subjektit në kontrollin e kriterit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve për koston dhe ligjshmërinë e burimeve të deklaruara të përdorura. Komisionerja Publike pretendon se deklaratimet e subjektit janë kontradiktore për *sipërfaqen* e objektit dhe *koston* e ndërtimit. Konkretisht, deklarimet në deklaratën *vetting*, në deklaratën e parë në vitin 2003, në deklaratën para fillimit të detyrës si prokurore, gjatë hetimit administrativ në pyetësorin nr. 2, si dhe në aktin e ekspertimit, ndryshojnë nga njëri-tjetri.

8.4. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit u shpreh se deklarimet e saj nuk arrijnë “pragun” e kontradiktës, pasi pasqyrojnë të njëjtin realitet, në momente të ndryshme në kohë.

⁸ Në këtë deklaratë të datës 03.06.2023, vjehri dhe vjehrra e subjektit deklarojnë se: “Përgjatë viteve 2004 – 2006, kemi vijuar ndërtimin e objektit me qëllim përfundimin e ndërtimit të nisur prej vitit 1994. Për ndërtimit e pjesës së mbetur të dyqanit, kemi përdorur huan nga z. I. Ç. 3.000.000 lekë dhe kursimet tona. Duke qenë se kam pasur objektiv që këtë objekt ta ndaj midis djemve, E. e kisha përfshirë në lejen e ndërtimit, ndërsa jetoja në një ekonomi me djalin tjetër, kam vendosur të investoj vetë për përfundimin e ndërtimit, pa kontribut material nga djali i madh”.

Mospërputhjet e etiketuara nga Komisionerja Publike janë ndryshime formale të shkaktuara nga evoluimi i dokumentacionit të ndërtimit. Ajo nuk ka investuar asnjëherë në këtë pasuri dhe atribuimi i kostove në ngarkim të saj do të përbënte tejkalim të procesit të rivlerësimit sipas standardeve të jurisprudencës së Kolegjit. Kostoja e ndërtimit duhet të përlllogaritet sipas akt ekspertizës së sjellë prej saj. Edhe ndërtimin në vitet 2004-2006 e ka përballuar vjehri nëpërmjet huave, ndërsa subjekti e ka ndërtuar ekonominë e saj familjare në Tiranë dhe veçmas. Bashkëshorti është përfshirë si bashkëpronar jo për shkak investimi, por për shkak të “traditës zakonore”. Të gjitha zhvillimet për efekt të ndërtimit kanë ndodhur përpara se subjekti të emërohej prokurore. Si rrjedhojë, pasuria nuk duhet t’i ngarkohet asaj për efekt të procesit të rivlerësimit.

8.5. Në vlerësim të akteve në fashikull dhe pretendimeve të palëve e shpjegimeve të subjektit në seancën gjyqësore, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore, të tilla që pamundësojnë kontrollin e ligjshmërisë së burimeve që kanë shërbyer për krijimin e saj. Edhe duke abstraguuar nga deklaratimet e ndryshme të *sipërfaqes* që ka kjo pasuri apo marrë në konsideratë që disa mospërputhje të këtij zëri paraqiten edhe në aktet zyrtare, rezulton që subjekti ka qenë në vijimësi *kontradiktore* dhe ka ndryshuar deklaratimet e saj edhe për treguesit e tjerë si *koha* e ndërtimit të pjesëve të ndryshme, *vlera* e investimit apo edhe *burimet* e krijimit. Këto ndryshime, përkundër pasqyrimin të së vërtetës, u panë si përpjekje për të shtuar/ndryshuar burimet e krijimit dhe për t’ia përshtatur ato nevojës për të përmirësuar situatën financiare të subjektit gjatë hetimit në procesin e rivlerësimit. Ky konstatim cenon besueshmërinë e deklaratimeve dhe shpjegimeve të saj. Për rrjedhojë, pretendimi i Komisioneres Publike gjendet i bazuar. Arsytimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

8.6. Sikurse referuar më sipër, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti janë bashkëpronarë të kësaj pasurie. Pasuria fillimisht është regjistruar në organet kompetente në emër të subjekti, bashkëshortit dhe prindërve të tij. Në datën 22.02.2020, subjekti ka nënshkruar një deklaratë noteriale në të cilën shprehte dakordësinë që pasuria në fjalë të regjistrohej në emër të bashkëshortit dhe prindërve të tij, duke shpjeguar se në këtë pasuri është investuar prej tyre *përpara martesës* së saj. Në dosje ndodhet një Urdhër i Brendshëm i Drejtuesit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “AShK”), i datës 26.02.2020, që urdhëron regjistrimin vetëm në emër të “poseduesve” – vjehrit, vjehrrës dhe bashkëshortit të subjektit, duke përjashtuar në këtë mënyrë subjektin e rivlerësimit nga lista e pronarëve. Po ashtu, sipas një akti të hartuar gjatë kësaj periudhe kohore për verifikimin në terren nga punonjës të AShK-së Fier⁹, sipërfaqja totale e ndërtimit është përrreth 350 m². Nga një kontroll i detajuar i akteve në fashikuj, u vërejt se:

a) ASHK-ja Fier, me shkresën e parë të datës 14.09.2021, ka informuar Komisionin për pronësinë e subjektit, personave të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur. Kjo shkresë evidenton se në emër të vjehrit dhe vjehrrës së subjektit, të personit të lidhur me subjektin, si dhe në emër të subjektit, figurojnë: një *godinë banimi* 2 kate [kati përdhe 172 m² dhe kati parë 178,1 m²], me *sipërfaqe totale* 172 m² dhe *godinë ekonomike* 2 kate [kati përdhe 105,4 m² dhe kati i parë

⁹ *Procesverbal i datës 26.02.2020. Ndërtimi informal ka sipërfaqe totale 201,5 m². Kati përdhe është 105,4 m² dhe kati i parë 96,1 m², ndërsa ndërtimi informal godinë banimi me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m², ka sipërfaqe totale ndërtimi 350,1 m², nga ku kati përdhe 172 m² dhe kati i parë 178,1 m².*

96,1 m²], me sipërfaqe totale 105,4 m². Të dyja pasuritë janë regjistruar me leje legalizimi të datës 28.02.2020.

b) ASHK-ja Fier, me një shkresë të dytë, të datës 24.11.2022, ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e pasurive të sipërcituara. Prej tyre ka rezultuar se investitori/vjehri i subjektit ka dorëzuar: (i) formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e objektit informal më datë 15.11.2006; (ii) akt kolaudimi të datës 20.10.2006, për objektin “market dhe banesë 3 kate”, me sipërfaqe totale 634 m²; (iii) akt kontrolli të datës 11.06.2006, i cili konkludon përfundimin e objektit dhe zbatimin e projektit teknik; (iv) leje shfrytëzimi e datës 06.11.2006 e objektit “market dhe banesë”, ku është cituar se objekti ka filluar funksionimin sipas destinacionit të miratuar në sheshin dhe lejen e ndërtimit.

c) Me anë të deklaratës noteriale të datës 24.02.2020¹⁰, bashkëshorti i subjektit dhe prindërit e tij kanë deklaruar se pasuria duhet të regjistrohet edhe në emër të tij [djalit të tyre], pasi ky i fundit ka kontribuar në ndërtimin e objektit. Deklaruesit shprehen se ndërtimi ka përfunduar në vitin 1997. Ky deklaram paraqet relevancë pasi daton dy ditë pasi subjekti ka deklaruar se pasuria duhet të mos regjistrohet në emër të saj, referuar në paragrafin 8.6. më sipër.

8.7. Në deklaratën e parë, plotësuar nga subjekti në funksionin e Oficeres së Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”), të marsit të vitit 2004, pasuria u deklarua përkatësisht: (i) banesë private e përbërë prej 1 kuzhinë, 1 salloni dhe 1 dhomë gjumi, me sipërfaqe 80 m², në të njëjtën ndërtesë me banesën e prindërve të bashkëshortit, e përbërë, gjithashtu, nga 2 dhoma e 1 kuzhinë, me vlerë 3.500.000 lekë, e ndërtuar në vitin 1998; dhe (ii) dyqan për tregtimin e pjesëve auto dhe vajra lubrifikantë, i cili është në të njëjtën ndërtesë me banesën, me vlerë 7.000.000 lekë, i ndërtuar në vitin 1998 nga vjehri dhe bashkëshorti i subjektit. Vlera totale e ndërtesës, sipas kësaj deklarate, rezulton 10.500.000 lekë.

8.8. Në deklaratën para fillimit të detyrës si prokurore, në vitin 2007 (dorëzuar në ILDKPKI në prill 2008), subjekti i rivlerësimit deklaroi pasurinë supermarket/dyqani i pjesëve të këmbimit të makinave dhe shtëpi banimi, me sipërfaqe 251 m², me vlerë 250.000 euro, duke shpjeguar se trualli është marrë nga shteti, ndërsa objekti është ndërtuar ndër vite, prej vitit 1995 e në vazhdim, nga vjehri dhe bashkëshorti i saj, me të ardhurat nga pagat dhe nga dyqani.

8.9. Në shpjegimet e dhëna në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 24.03.2016, ndër të tjera, subjekti deklaroi se kjo banesë është ndërtuar ndër vite duke filluar nga viti 1995 e më tej. Ky objekt është ndërtuar nga vjehri i saj dhe personi i lidhur/bashkëshorti, me të ardhura të tyre familjare të krijuara ndër vite dhe e krijuar para martesës, që është në bashkëpronësi të vjehrit dhe bashkëshortit të saj. Në pyetësin nr. 2, të Komisionit, subjekti shpjegoi se *ndërtimi në fakt nisi në vitin 1994*.

8.10. Në rezultatet e hetimit, për analizën e mundësisë financiare të krijimit të pasurisë, Komisioni llogariti koston mesatare [të ndërtimit], sipas çmimit të EKB-së në vitet përkatëse, duke zbritur kostot për fitimin e planifikuar dhe fondin rezervë. Pas kësaj analize, Komisioni konstatoi se vlera totale për ndërtimin e godinës së banimit dhe njësisë së shërbimit ishte 8.634.323 lekë. Sipas kësaj analize, prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej (-) 4.503.237 lekësh, për krijimin e pasurisë përgjatë periudhës 1994 – 1998. Për ndërtimin përgjatë periudhës 2004 – 2006, prindërit e bashkëshortit

¹⁰ Që është dy ditë pas deklaratës së subjektit për të vijuar regjistrimin në emër të këtyre të fundit.

të subjektit kanë pasur burime të ligjshme financiare për pjesën e tyre, ndërsa subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej (-) 1.479.821 lekësh. Për këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës.

8.11. Në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit parashtroi se këtë pasuri e gjeti të ndërtuar para martesës¹¹ dhe kërkoi ndryshimin e analizës financiare, nëpërmjet rishikimit të disa zërave. Konkretisht, përveç zbritjes së 8.83% të kostos sipas EKB-së, kërkoi të zbritet TVSH-ja e pagueshme dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, me pretendimin se është ndërtuar me ndihmë të të afërmeve dhe jo nga ndonjë firmë ndërtimi. Në konkluzion, subjekti theksoi se nuk kishte lidhur martesë në periudhën që përkon me ndërtimin e viteve 1994 – 1998, dhe se bashkëshorti i saj nuk gjeneroi as të ardhura në këtë periudhë. Për rrjedhojë, kjo pasuri është krijuar me burime financiare të familjes së bashkëshortit. Subjekti pretendoi vlera negative të ndryshme nga rezultati i Komisionit, në masën (-) 1.029.206 lekë, që konsistonin në përlllogaritjen e kostos së ndërtimit me vlerë të ndryshme nga ajo e EKB-së.

8.12. Për të saktësuar kohën e ndërtimit dhe sipërfaqen e objektit, Komisioni komunikoi edhe me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (në vijim “ASIG”), si dhe kontrolloi edhe vetë të dhënat nga ky portal. Nga komunikimi, ASIG-u dërgoi në Komision *ortofoto* të objektit të viteve 1994 dhe 2001. Prej tyre, Komisioni konstatoi se në vitin 1994 dallohet një gjurmë ndërtimi e godinës së banimit, së paku njëkatëshe, ndërsa në vitin 2001 konstatoi një godinë banimi. Në imazhin e vitit 2004, sipas Komisionit, konstatohet ndërtimi edhe i një pjese tjetër përpara godinës që duket edhe në *ortofoton* e vitit 2001, që Komisioni e konsideroi rreth 1/3 e katit të parë. Gjithashtu, Komisioni kërkoi informacion nga ASHK-ja Fier (sipas shkresave/përgjigjeve të sipërcituara).

8.13. Në deklaratën *vetting*, subjekti e ka deklaruar pasurinë me sipërfaqe 634 m² dhe në të njëjtën deklaratë, bashkëshorti i saj e deklaroi pasurinë, sipas vërtetimit hipotekor datë 07.12.2006. Ky vërtetimi hipotekor, që është akti i cili disponohet në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, pasqyron një sipërfaqe 251 m² të pasurisë “supermarket” me nr. {***} dhe nuk ka informacion për sipërfaqen e godinës [tjetër të banimit]. Referuar aktit të kolaudimit të datës 20.10.2006, sipërfaqja e përlllogaritur në total është 634 m², aq sa e ka deklaruar subjekti dhe personi i lidhur.

8.14. Nga aktet në fashikull, përmbajtja e të cilëve referohet në nënpjesët e paragrafit 8.6. më sipër, rezulton se ndërtesa ka përfunduar në nëntor 2006, për të ka pasur një akt kolaudimi të datës 20.10.2006 dhe një akt kontrolli të qershorit të të njëjtit vit, si dhe një leje shfrytëzimi e nëntorit 2006, në të cilën konfirmohet se *objekti ka filluar funksionimin sipas destinacionit të miratuar në sheshin dhe lejen e ndërtimit*. Sipërfaqja referohet me pjesët përbërëse përkatëse¹². Në këtë dosje administrohet edhe vërtetimi i pasurisë, i sipërpërmendur, në të cilën është shënuar pronësia e vjehrrit dhe bashkëshortit të subjektit, që mban datën e regjistrimit 07.12.2006, dhe paraqet një sipërfaqe [të pasurisë “supermarket”] prej 251 m². Sipërfaqja që pasqyron akti i kolaudimit të vitit 2006 nuk përputhet me përshkrimet e miratuara në lejen e sheshit të ndërtimit të vitit 1995, që sheshi ishte 800 m², pasi në vendimin e KRRt-së Fier, që dha lejen e ndërtimit në maj të vitit 2004, nuk ka sipërfaqe ndërtimi.

¹¹ Paragrafi 105 i vendimit të Komisionit në: <https://aksesdrejtesi.al/dokumenta/1689326589Vendim-Mirela-Zavalani.pdf>

¹² Sheshi 500 m², bodrumi 79 m², kati përdhe/market 251 m² dhe sipërfaqe e kati i parë/banesë 304 m².

8.15. Nga ana tjetër, aktet nga ALUIZNI në vitin 2020 dhe *ortofotot* dhe shkresa e parë e ASHK-së e datës 14.09.2021, tregojnë që bëhet fjalë për dy godina të ndryshme -- ASHK-ja Fier e konfirmon pasurinë me dy numra të ndryshëm reference, sipërfaqeje dhe përshkrimesh. Po ashtu, nga aktet rezulton se gjatë procesit të regjistrimit të pasurisë në vitin 2020, u krye edhe ndarja e praktikave dhe regjistrimi i pasurisë edhe në emër të subjektit, pavarësisht se ajo dorëzoi një deklaratë noteriale [datë 22.02.2020] që hiqte dorë nga pronësia. Pavarësisht deklaratës së heqjes dorë, kartela e pasurisë e vitit 2021 e referon edhe subjektin si pronare. Në kushtet që një pjesë e investimit pranohet të jetë kryer nga personi i lidhur dhe subjekti, pasi këta të fundit kishin lidhur martesë në vitin 1999, ky detaj i dokumentacionit duket në harmoni me gjithë panoramën e të drejtave të pronësisë. Sikurse arsyetohet më sipër, këto detaje kanë relevancë për sa i përket analizës financiare të burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti dhe bashkëshorti për investimet e kryera prej tyre dhe saktësinë e deklarimeve për efekt të deklaratës *vetting*.

8.16. Në deklaratën para fillimit të detyrës si prokurore në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi pasurinë objekt analize, me sipërfaqe 251 m² dhe me vlerë 250.000 euro. Sipërfaqja e deklaruar nga subjekti përputhet me sipërfaqen e pasqyruar në vërtetimin hipotekor të nëntorit 2006, të lëshuar pas ndërtimit të pjesës së dytë të godinës. Vlera e deklaruar nga subjekti, nga ana tjetër, nuk përputhet me formularin e rivlerësimit në vitin 2012 që ka plotësuar vjehrri i saj, sipas së cilit vlera e pasurisë së regjistruar në vitin 2006 është 7.265.948 lekë. Kjo vlerë është jo vetëm shumë më e ulët sesa ajo që ka deklaruar subjekti në vitin 2007, por edhe më e ulët se vlera e deklaruar në deklaratën e parë të vitit 2003, referuar si 10.500.000 lekë, dhe mbi dyfish më e lartë se vlera sipas rivlerësimit, deklaruar në masën 11.295.000 lekë [në deklaratën *vetting*]. Shpjegimet e subjektit se ajo deklaroi vlerën *e menduar* të tregut janë të paqarta dhe të pashpjegueshme logjikisht, pasi në harkun kohor 2003 – 2007, ndërtesës i atribuohet rritje disafish e vlerës që do të bënte kuptim me shtesën e investimit në vitin 2004 e pas, nëse nuk do të binte ndesh dukshëm me deklarimin e vjehrriit pranë ZVRPP-së Fier, në vitin 2012, dhe sugjeron një vlerë të fryrë, shumë më të lartë sesa ajo e konkluduar në rivlerësimin e pasurisë përpara janarit 2017.

8.17. Këto kontradikta kanë relevancë kryesisht edhe si kundërargument i pretendimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit për të përlllogaritur një kosto ndërtimi të ndryshme, bazuar në raportin e vlerësimit të hartuar gjatë rivlerësimit, prej përreth 4.017.936.73 lekësh, që duket jo realiste në krahasim me secilën prej vlerave të sipërpërmendura, përfshirë edhe atë sipas rivlerësimit të ZVRPP-së Fier, vlera totale e objektit është llogaritur në shumën 11.295.000 lekë¹³. Për më tepër, shifrat e dhëna nga subjekti apo pretendimet se ka dhënë vlerën që ajo ka menduar se kishte pasuria në vitin 2007 janë të pakuptimta, pasi nënkuptojnë një vlerë të shtuar në mënyrë shpërpjesëtimore për një ndërtesë të krijuar me kosto thujse të papërfillshme nëse, sikurse ka pranuar Komisioni, punimet e ndërtimit janë kryer nga familjarë kundrejt shpërblimesh modeste, në rastin më të mirë¹⁴. Kjo panoramë, po ashtu, merr rëndësi në kushtet që nga aktet në fashikull rezulton se në lejen e ndërtimit, punimet janë referuar të kryera nga

¹³ Vlera e rivlerësuar e objektit nga ana e ZVRPP-së Fier është llogaritur në shumën 11.295.000 lekë, sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor datë 11.12.2006, për pasurinë ndërtesë me sip. 251 m² në Patos, në bashkëpronësi të z. E. Z. (vjehrri i subjektit) dhe bashkëshortit të subjektit, ku sipas shënimit, rivlerësimi është bërë në vitin 2012.

¹⁴ Referuar pretendimeve të subjektit në pyetësin nr. 2, punimet i ka kryer vetë vjehrri i subjektit, me të vëllanë murator e elektrikist, ndihmuar nga të afërm e miq të tij.

një person juridik dhe inxhinier ndërtimi¹⁵. Si e tillë, vlera e raportit të ekspertimit vjen në kontradiktë me aktet dhe vlerësohet pa peshë provuese.

8.18. Nga ana tjetër, edhe nga aktet e organeve shtetërore nuk arrihet një konkluzion për vlerën dhe sipërfaqen konkrete të pasurisë së krijuar në kohën kur u ndërtua. Konkretisht, për pjesën e parë të ndërtimit, është dhënë leja e sheshit të ndërtimit me sipërfaqe 800 m², me vendimin e datës 08.12.1995 dhe me vendimin e datës 26.03.1996 është dhënë leja e ndërtimit të objektit “supermarket në {***}”, pa e përcaktuar sipërfaqen e ndërtimit e as katet e objektit, por në të është shënuar se sheshi i ndërtimit është miratuar me vendimin e KRT-së Fier nr. {***}, datë 18.10.1993 “Për dhënien e sheshit të ndërtimit”. Këshilli i Bashkisë Patos, me vendimin e datës 02.06.1994, për lejen e sheshit të ndërtimit, ka të shënuar se *mbi bazë të kërkesës datë 13.10.1993, ju jepet sheshi i ndërtimit me sipërfaqe 500 m²*. Në këtë mënyrë, ndërsa aktet e organeve shtetërore që miratuan lejen e ndërtimit të pjesës së parë të godinës, paraqesin sipërfaqe të ndryshme të sheshit dhe sipërfaqja e ndërtimit, në deklaratën e parë të detyrës si Oficere e Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”) në vitin 2003, ishte 80 m². Përgjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në Kolegj, subjekti nuk u investua që të evidentonte në mënyrë shteruese sipërfaqet e objektit që u ndërtuan në vitet përkatëse.

8.19. Për sa më lart, për shkak se aktet zyrtare paraqesin sipërfaqe të ndryshme, në analizën e kryer në Kolegj, u përllogarit sipërfaqja e ndërtimit në 630 m², deklaruar në deklaratën *vetting*. Vlera e rivlerësuar e pasurisë u përllogarit ajo e deklaruar në deklaratën *vetting*, ndërsa kostoja u përllogarit sipas vlerave të referencës sipas EKB-së.

8.20. Për kontradiktat në lidhje me *periudhën* e ndërtimit, përpos sa arsyetuar më lart, analiza e trupit gjykues të Kolegjit u fokusua në drejtim të besueshmërisë së subjektit, në kushtet që në këndvështrimin e ngushtë financiar, investimet e kryera përpara vitit 1999 nuk janë pjesë e vlerësimit për këtë pasuri, sipas qasjes së Komisionit dhe shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike. Konkretisht, edhe në shkaqet e ankimit, Komisionerja Publike, në linjë me Komisionin, ka kërkuar që analizës financiare t’i nënshtrohen investimet dhe shpenzimet në periudhën kohore 01.01.2004 – 31.10.2007¹⁶, pasi ndërtimi i pjesës së parë konsiderohet i ndodhur përpara martesës së subjektit me bashkëshortin në vitin 1999.

8.21. Për efekt dhe në linjë me këtë këndvështrim, koha e krijimit të pasurisë objekt analize, në të cilën subjekti jetoi nga koha kur u martua e derisa u transferua në Tiranë në vitin 2006, koha e ndërtimit paraqet rëndësi për efekt të saktësisë së deklarimeve të subjektit. Nga aktet në fashikull rezulton se leja e parë për sheshin e ndërtimit mban datën 02.06.1994. Mbi bazën e një kërkesë të dytë të bashkëshortit dhe vjehrrit të subjektit, të datës 12.09.1995, atyre iu është dhënë sheshi i ndërtimit me sipërfaqe 800 m². Me një vendim të datës 26.03.1996, të KRRt-së së rrethit Fier, vjehrrit dhe bashkëshortit të subjektit iu është dhënë përsëri një leje tjetër ndërtimi. Për pjesën e dytë të ndërtimit, administrohen akte të organeve shtetërore për nisjen dhe përfundimin e objektit -- me vendimin e KRRt-së Fier të datës 18.05.2004, është miratuar ndërtimi i godinës 3 kate dhe market. Kjo godinë iu është nënshtruar procedurave të legalizimit,

¹⁵ Sipas lejes së ndërtimit lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Fier në datën 26.03.1996, subjekti që do të zbatojë punimet është firma {***}, ing. G. B..

¹⁶ Paragrafi 13.7 i ankimit, në:

<https://aksesdrejtesi.al/dokumenta/1690527657Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-673-dat%C3%AB-15.6.2023-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-znj.-Mirela-Zavalani.pdf>

me vërtetimin hipotekor të datës 07.12.2006 dhe vetëdeklarimi i legalizimit i datës 15.11.2006, për sipërfaqen 251 m².

8.22. Nga kontrolli i akteve në dosje dhe të shpjegimeve të subjektit që i përkasin pjesës së parë të ndërtimit, pretendimi i Komisioneres Publike se deklaratimet paraqiten në disa versione, dhe jo të qarta, është i drejtë. Konkretisht:

- a) në deklaratën e parë të vitit 2003, subjekti e deklaroi pasurinë si *të ndërtuar në vitin 1998*;
- b) në deklaratën e parë si prokurore, të vitit 2007, subjekti deklaroi se pjesa e parë e ndërtesës është ndërtuar *ndër vite*, nga viti 1995 e në vazhdim, pa dhënë një fund kohor;
- c) në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 24.03.2016, vetëm disa muaj përpara deklaratës *vetting*, subjekti deklaroi se ndërtimi nisi në vitin 1995;
- d) gjatë hetimit në Komision, subjekti u përgjigj se në fakt, viti 1995 përkon me përfundimin e ndërtimit të katit përdhe;
- e) më tej, në një deklaratë noteriale të vjehrrit, vjehrrës dhe bashkëshortit të saj, datë 24.02.2020, që subjekti e dërgoi bashkë me pyetësorin nr. 2, është deklaruar vetëm në terma të përgjithshëm se *objekti është ndërtuar para vitit 1997*;
- f) në përgjigje të pyetësorëve, për kohën e ndërtimit, subjekti deklaroi se *ndërtimi ka nisur me sheshimin e sipërfaqes që në vitin 1994*;
- g) në deklaratat noteriale të tre personave që pretendohet se kanë ndihmuar me ndërtimin, hartuar *gjatë* hetimit administrativ, në datën 23.11.2022, periudha kohore vendoset në vitet 1993 – 1998.

8.23. Nga sa më sipër, rezulton qartë që subjekti ka ndryshuar pragun kohor të fillimit të ndërtimit për t'iu përshtatur fazës në të cilën jepej përgjigja. Për rrjedhojë, është i bazuar pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti ka qenë jokoherente në deklarinimin e detajeve të ndryshme me relevancë në kontrollin e kësaj pasurie edhe parë në drejtimin e kohës kur ka nisur investimi. Ky konkluzion mban në konsideratë disa aspekte. *Së pari*, ndonëse është në diskutim një periudhë kohore përpara se subjekti të ndërthurte interesat e saj me familjen e bashkëshortit, trupi gjyqësor i Kolegjit thekson se për shkak të rëndësisë së pasqyrimin me vërtetësi e plotësi të deklaratës *vetting* dhe pasojat në jetën profesionale të saj, subjekti kishte përgjegjësinë të qartësonte saktë kohën e krijimit të pasurisë. *Së dyti*, edhe duke abstraguuar nga vlera provuese e kufizuar që kanë deklaratat noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit për efekt të besueshmërisë, deklaratat e mësipërme të personave të ndryshëm privatë që pretendohet të kenë kontribuar me krahë pune për ndërtimin, bien ndesh edhe në përmbajtje me aktet e tjera, përfshirë edhe atë kohor, pasi vetë subjekti dhe vjehri janë shprehur se ndërtimi nisi në vitin 1994, apo 1995. Komisioni, në një qasje favorizuese, ka pranuar përmbajtjen e këtyre deklaratave pjesërisht duke konsideruar të besueshëm ndërtimin me shpenzime të reduktuara [analizuar më sipër], duke mos përllogaritur vlerë të fitimit dhe fond rezervë në koston e ndërtimit, pavarësisht se nga dokumentacioni ndërtimi i referohet një personi juridik. Ndërsa për kohën e ndërtimit, Komisioni duket t'i ketë gjetur jo të besueshme këto deklarata, duke zgjedhur ta vendosë ndërtimin në vitin 1994, deri në vitin 1998, tërësisht përpara martesës.

8.24. Pjesa e dytë e ndërtimit/investimit është pasuri e krijuar pas martesës së subjektit, përtej çdo kontestimi, ndonëse subjekti tenton ta pasqyrojë investimin si pasuri mbi të cilën ajo nuk

ka kontribut. Deklarimi në deklaratën *vetting* si pasuri e krijuar *para martesë*, në pronësi të vjehrrit e bashkëshortit bie ndesh me prezumimin ligjor të regjimit të *bashkësisë ligjore* për pasurinë martesore, në kushtet që subjekti ka lidhur martesë në korrik 1999, përpara se të kryhej shtesa e investimit ndërtimor në vitet 2004 – 2006. Ky aspekt gjen pasqyrim edhe në kartelën e pasurisë së vitit 2020, ku ajo është një ndër bashkëpronarët, për sipërfaqen 172 m². Kartela e pasurisë, e printuar në datën 02.08.2021, përpos bashkëshortit dhe vjehrrit të subjektit, tregon edhe subjektin e rivlerësimit si pronare të pasurisë së fituar me lejen e legalizimit të datës 28.02.2020 e të regjistruar në datën 24.02.2021.

8.25. Në rezultatet e hetimit, subjekti e ka lidhur me procesin e rivlerësimit deklaratën e saj noteriale për të hequr dorë dhe korigjuar aktet e pronësisë dhe pasqyruar atë si pasuri të krijuar tërësisht përpara martesë. Ky moment kohor, e konkretisht hapat e ndërmarrë nga familja e bashkëshortit dhe ai vetë për ndryshimin e pronarëve të pasurisë, në ZVRPP e ALUIZNI-t datë 24.02.2020, ndonëse nuk përkon ekzaktësisht me procesin e rivlerësimit për atë vetë¹⁷, në thelb është pa relevancë, pasi ndërkohë procesit të rivlerësimit i ishin nënshtruar shumë subjekte, përfshirë edhe në institucionin ku shërbente subjekti¹⁸.

8.26. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe që në deklaratën për herë të parë periodike, hartuar si OPGj në vitin 2003, subjekti referon bashkëpronësi në 40% të njësisë së shërbimit/supermarketit dhe në mënyrë konsistente, në vijim ndër vite ka deklaruar fitime nga të ardhurat që gjeneron ky aktivitet, i menaxhuar nga kunati. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokurore [hartuar në prill 2008], subjekti madje e deklaroi apartamentin e banimit dhe supermarketin si një ndër pasuritë e paluajtshme që disponon vetë dhe referon aktin e pronësisë, sipas ZVRPP-së Fier lëshuar në vitin 2006. Për pasojë, deklarimi në deklaratën *vetting* rezulton të jetë në kundërshtim me aktet e kohës, me deklaratimet e subjektit për pjesën e dytë të ndërtimit dhe me prezumimin ligjor të regjimit të bashkësisë martesore, të pakundërshtuar me ndonjë nga aktet. Ky aspekt bie ndesh edhe me shpjegimet gjatë hetimit administrativ, se një pjesë e pasurisë u ndërtua përgjatë viteve 2004 – 2006, që është edhe një periudhë kohore gjatë së cilës, deri në datën 30.01.2007, subjekti e bashkëshorti ishin edhe në një certifikatë familjare të përbashkët me prindërit e tij [bashkëshortit] dhe jetonin në banesën pjesë e godinës së ndërtuar përpara martesë.

8.27. Për më tepër, dhe përpos faktit që objekt deklarimi e kontrolli i pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit janë të gjithë pasuritë e akumuluar ndër vite të personave të lidhur me subjektet, subjekti jetoi në këtë banesë për më së paku gjashtë vite dhe krijoi të ardhura të gjeneruara prej saj, deklaruar e pranuar përtej çdo kontestimi. Në këto kushte, në linjë me jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet subjektit për mënyrën dhe kohën e krijimit të pasurisë dhe mospërputhjet e dukshme në variantet e dhëna prej saj mes tyre dhe me aktet, nuk mund të argumentohen përveçse si përpjekje për distancim nga pasuria për efekt të procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, edhe zgjedhja favorizuese e

¹⁷ Shorti për subjektin është hedhur në datën 15.06.2020 dhe njoftimi për fillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit është i datës 22.07.2020.

¹⁸ <https://www.aksedrejttesi.al/dokumenta/1596788829Raport-statistikor-vjetor-2019.pdf>. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kishte dhënë 224 vendime deri në janar 2020. Ndër çështjet në të cilat ka qenë objekt kontestimi pasuritë e krijuara në raport me regjimin e bashkësisë ligjore për shkak të martesës, rezulton të jetë ajo e subjektit të rivlerësimit E. Imeraj, në atë kohë në të njëjtën prokurori me subjektin. Në atë proces, hetimi i dytë administrativ është çelur në 13.11.2019, ndërsa rezultatet e të parit i ishin bërë të njohura subjektit që në tetor 2019.

Komisionit, duke mbajtur si kriter periudhën kur subjekti ushtroi detyrën e prokurores¹⁹, është e pabazuar në ligj dhe në jurisprudencën e Kolegjit, elaboruar gjerësisht në vendime që paradatojnë vendimin objekt shqyrtimi²⁰.

8.28. Në përmbledhje të sa më sipër, në ndryshim nga konkluzioni i Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se pretendimet e subjektit në procesin e zhvilluar në Kolegji, për të mos bërë pjesë të analizës financiare investimet e kryera në vitet 2004-2007 në objektin banesë dhe njësi tregtare, u vlerësuan të pambështetura në akte dhe jobindëse, pasi janë kontradiktore me njëra-tjetrën dhe me aktet e administruara. Trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë disa aspekte, përfshirë që: (i) subjekti dhe familja e saj jetuan në banesën pjesë e ndërtesës për një periudhë 6-vjeçare dhe (ii) subjekti dhe bashkëshorti janë pronarë të gjysmës së pasurisë, sikurse edhe kanë deklaruar përqindje të pjesës takuese të fitimeve nga aktiviteti privat që gjeneron njësi tregtare, qoftë në deklaratat periodike apo edhe në atë *vetting*, ndërkohë që dokumentacioni ligjor provon që personi i lidhur/bashkëshorti i saj ishte në mënyrë të vazhdueshme si bashkëfinancues dhe bashkëpronar i kësaj pasurie. Kjo bashkëpronësi ka vijuar dhe në të është përfshirë edhe subjekti i rivlerësimit pas martese [në investimet e kryera në vitet 2004-2007]. Për këto arsye, në analizën e kryer në Kolegji, kjo pasuri iu nënshtrua kontrollit.

8.29. Komisionerja Publike potencon se edhe kontradiktat në deklarin e burimeve të krijimit të pasurisë për periudhën 2004 – 2006 duhet të vlerësohen në drejtim të besueshmërisë së subjektit në drejtim të kostos dhe ligjshmërisë së burimeve të deklaruara të përdorura. Komisionerja Publike pretendon se nga analiza financiare për periudhën 01.01.2004 – 31.10.2007, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e periudhës. Përveç pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar edhe në analizën e Komisionit, Komisionerja Publike kërkon rishikimin edhe të disa zërave të tjerë, si llogaritjet e Komisionit mbi shpenzimet e jetesës për vitin 2007, si dhe të ardhurat nga qiraja/fitimi i aktivitetit privat.

8.30. Në kontrollin e analizës financiare të kryer në vijim të sa më sipër, edhe në Kolegji u konfirmua *minimalisht* [më së paku] balanca negative financiare e konstatuar nga Komisioni për investimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti për këtë pasuri në vitet 2004-2007. Duke abstraguuar nga fakti që është e paqartë sesi Komisioni e ka përlllogaritur balancën negative përreth 1.300.000 lekë, të konkluduar në vendim për këtë periudhë, në analizën e kryer në funksion të këtij shkaku ankimi, në Kolegji, u korrektuan edhe shpenzimet e jetesës për vitin 2007 për të pasqyruar standardin e referuar nga INSTAT, konfirmuar e përdorur gjerësisht nga Kolegji në jurisprudencën e tij ndër vite. Në kushtet që Komisioni ka përlllogaritur një vlerë konsiderueshëm më të ulët, duke e favorizuar subjektin edhe me këtë zë shpenzimesh, pretendimi i Komisioneres Publike u vlerësua i bazuar.

¹⁹ Paragrafi 190 i vendimit të Komisionit: “Vlen të theksohet se nga ky bilanc i përgjithshëm negativ pamundësia financiare pas vitit 2007 – përgjatë periudhës që subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit – ka rezultuar në vetëm - 428.356 lekë, ndërkohë që pjesa tjetër i referohet periudhës së mëhershme”.

²⁰ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, (JR) nr. 8/2023, subjektit të rivlerësimit Artan Zeneli (JR) nr. 2/2019, subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi (JR) nr. 37/2021. Së fundmi, në vendimin (JR) nr. 3/2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri, Kolegji ka arsyetuar: “Së pari, neni 30 i ligjit nr. 84/2016 dikton kontrollin e pasurive të personave të lidhur me subjektet. Kjo dispozitë nuk kushtëzohet a priori nga ndonjë moment kohor për personat e lidhur. Edhe duke abstraguuar nga kontrolli ipso lege, të cilit i nënshtrohen personat e lidhur, lëvizja në kohë e kontrollit të mundësive financiare të vjehrrit për vetëm një vit, gjithsesi, vite përpara dhurimit të vitit 2011 – nga viti 2004 në vitin 2005 – ka pasur si pasojë vetëm përjashtimin nga analiza e këtij shpenzimi”.

8.31. Çmohet të theksohet se në këtë analizë, në respektim edhe të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit *nuk* e ngarkoi subjektin e rivlerësimit me balancën negative të konsiderueshme, që rezultoi për krijimin e kësaj pasurie nga prindërit e bashkëshortit të subjektit dhe ai vetë, si dhe për shpenzimet e kryera për këtë pasuri në harkun kohor deri në vitin 1999 [viti i martesës ligjore të subjektit]. Balanca negative e konstatuar u mbajt në konsideratë vetëm në funksion të kontributeve të familjarëve të bashkëshortit si *persona të tjerë të lidhur* – në raport me subjektin e rivlerësimit, për dhurimin e shumës 700.000 lekë në vitin 2007 -- pretenduar nga subjekti si burim për krijimin e apartamentit në Tiranë, i analizuar në vijim.

8.32. Në këtë aspekt, është me rëndësi të theksohet që trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi jobindëse pretendimet e subjektit se burim për krijimin e pasurisë ka shërbyer edhe një hua prej 3.000.000 lekësh, marrë nga vjehri i subjektit një të afërmi të saj në vitet 2002 dhe 2004. Ky konstatim u bazua në dy drejtime kryesore: momentin kur subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë hua, si dhe mospërputhjet me logjikën ekonomike të veprimeve që rezultojnë nga rrethanat që pretendon subjekti.

8.33. Konkretisht, huaja në fjalë është pretenduar si burim për herë të parë gjatë hetimit administrativ, ndërkohë që në deklaratën *vetting* apo deklaratat ndër vite, deri në mars 2016 kur është pyetur nga ILDKPKI-ja, subjekti ka dhënë detaje specifike që i kufizojnë burimet të variojnë nga të ardhurat e familjes, nga puna e prindërve të bashkëshortit, nga shitja e apartamentit [në deklaratën *vetting*] apo të ardhurat nga dyqani/njësia tregtare. Përpos këtij aspekti, edhe shpjegimet e subjektit lidhur me rrethanat për të cilat huaja e marrë nga vjehri i subjektit xhaxhait të saj, jo vetëm nuk u përdor për qëllimin për të cilin u mor, por administrohej kryesisht nga bashkëshorti i saj, i cili vilte edhe interesat nga depozita e pretenduar e krijuar me gjysmën e dytë të huas. Në panoramën faktike të pretenduar, subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë të vetmit përfitues nga një detyrim i konsiderueshëm me të cilin ishin ngarkuar familjarët e tyre, ndërkohë që në vijimësi janë edhe përfitues të shumës prej 700.000 lekësh të dhuruar nga prindërit e bashkëshortit në funksion të krijimit të pasurisë së dytë të analizuar, sikurse edhe përfitues fitimesh nga aktiviteti për të cilin, sipas shpjegimeve të subjektit në procesin e rivlerësimit, ata nuk kanë dhënë asnjë kontribut financiar.

8.34. Mungesa e besueshmërisë për huan afektoi kontrollin e pasurisë së subjektit për shumën prej 1.500.000 lekësh, depozituar në *cash* nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në datën 18.06.2004 dhe tërhequr në tre pjesë gjatë vitit 2006, që ka efekt mbi këtë pasuri dhe atë të analizuar në vijim. Për sa më sipër, dhe përpos kontradiktave e mospërputhjeve në deklaratimet e subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, përcaktuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion bazohet në arsyetimin që shtjellohet në vijim.

8.35. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi si burime të krijimit të pasurisë në Patos: (i) të ardhurat nga prindërit e bashkëshortit nga puna; dhe (ii) shitja e apartamentit ku jetuan më parë. Edhe personi i lidhur me subjektin deklaroi të njëjtat burime. Në deklaratën e parë të vitit 2003, subjekti nuk deklaroi burime të krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën e parë të fillimit të detyrës si prokurore, në prill 2008, subjekti deklaroi pasurinë të ndërtuar ndër vite me të ardhurat e *pagave* dhe të dyqanit. Në procesverbalin e ILDKPKI-së në vitin 2016, subjekti deklaroi se pasuria është krijuar me të ardhurat *familjare* ndër vite. *Së fundmi*, gjatë hetimit

administrativ, pyetur që të saktësojë burimet e krijimit të pasurisë²¹, subjekti deklaroi se shërbyen si burime: (i) të ardhurat e prindërve të bashkëshortit nga punësimi ndër vite, që Komisioni i përllogariti që nga viti 1994 - 2006; (ii) të ardhurat nga interesat nga firmat rentiere/piramidale; (iii) të ardhurat nga dyqani; (iv) të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 1999, në masën 300.000 lekë; si dhe (v) huaja që vjehri mori nga xhaxhai i saj [I. Ç.] në shumën 3.000.000 lekë, përgjatë viteve 2002 dhe 2004, por që u depozituan në llogarinë e bashkëshortit të subjektit. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se ka deklaruar vetëm burimin fundor në deklaratat e mëparshme, ndërsa huaja në fjalë nuk u deklarua, pasi është shlyer nga prindërit e bashkëshortit të subjektit. Subjekti paraqiti edhe një deklaratë noteriale të datës 26.11.2005, që referon huamarrjen në fjalë në tetor 2002 dhe qershor 2004 në pjesë të barabarta, në total prej 3.000.000 lekësh.

8.36. Komisioni mbajti në konsideratë se pjesa e dytë e godinës nisi në vitin 2004, dhe analizën financiare e kreu me kontribut të barabartë midis subjektit dhe bashkëshortit, si dhe prindërve të tij. Komisioni përfshiu në analizë të ardhurat që u gjeneruan nga dyqani përgjatë kësaj periudhe, pasi arsyetoi se *mund* të kenë shërbyer si burim për ndërtimin e pjesës së dytë të godinës, përgjatë periudhës 2004 – 2006. Komisioni përfshiu në analizë edhe huan e dhënë vjehrit të subjektit, nga krushku i tij, xhaxhai i saj. Komisioni ka mbërritur në një balancë negative të subjektit dhe bashkëshortit prej (-) 1.359.401 lekësh, përllogaritja e të cilës u vlerësua e pamundur të qartësohet në Kolegj. Komisioni ka përllogaritur shpenzime jetese më të ulëta për vitin 2007 sesa standardi i INSTAT-it përdorur nga organet e rivlerësimit, ka rillogaritur shpenzimet e ndërtimit duke kryer zbritjet e kërkuara nga subjekti dhe përfshirë të ardhura nga qiraja e dyqanit.

8.37. Duke i gjetur të bazuara kërkimet e Komisioneres Publike, trupi gjykues i Kolegjit nuk përfshiu në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti e familja e saj [përfshirë edhe prindërit e subjektit] huan nga xhaxhai i saj në vlerën totale prej 3.000.000 lekësh, si dhe të ardhurat nga dyqani, analizuar në vijim. Nga kjo analizë, duke ndjekur logjikën financiare të përdorur nga Komisioni, për shkak të kufijve të shkaqeve të ankimit, edhe në analizën e kryer në Kolegj, subjekti dhe bashkëshorti rezultuan me një balancë *negative* të konsiderueshme për pjesën e tyre të kontributit në vlerën që vetëm për ndërtimin është më së pak (-) 4.303.608 lekë, ndërsa rezultati i periudhës do të ishte (-) 7.230.397 lekë.

8.38. Huaja nga xhaxhai i subjektit nuk është deklaruar si burim krijimi i ndonjë pasurie dhe as si marrëdhënie juridike. Gjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja në mars 2016, subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë hua, por në funksion të krijimit të depozitave të bashkëshortit që analizohen në vijim. Nga ana tjetër, në deklaratën e parë të vitit 2003, kur subjekti deklaroi në cilësinë e OPGj-së, është shprehur se si burim i depozitës me vlerë 1.200.000 lekë në emër të bashkëshortit, kanë shërbyer të ardhurat e saj dhe të personit të lidhur nga pagat dhe të ardhurat nga dyqani i shitjes së pjesëve të këmbimit [që personi i lidhur ka së bashku me vëllanë e tij].

8.39. Nën dritën e këtyre akteve të hartuara më afër në kohë, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar argumentimin e Komisioneres Publike dhe nuk e përfshiu këtë shumë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara për investimin në ndërtimin e viteve 2004 – 2006. Në këtë konkluzion, përpos kohës dhe kontradiktave të destinacionit të përdorimit të kësaj huaje në

²¹ Me pyetësozin nr. 2.

deklarimet e ndryshme në kohë nga subjekti, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë edhe aspekte të tjera që e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit dhe të pabazuar qëndrimin e Komisionit për ta pranuar këtë marrëdhënie juridike si burim krijimi të pasurisë objekt analize. Konkretisht, në kushtet që në analizën e kryer nga Komisioni, vjehëria/prindërit e bashkëshortit të subjektit rezultojnë me mundësi financiare për të përballuar pjesën e tyre takuese në investimin e ndërtimit në vitet 2004 – 2006, marrja e huas duket alogjike – në premisat e logjikës së Komisionit, pasqyruar në paragrafët nr. 98 – 99 të vendimit²². Për më tepër, subjekti përpiket të prezantojë një panoramë sipas së cilës prindërit e bashkëshortit të saj, ndonëse kishin të ardhura të mjaftueshme dhe ishin në punë, morën hua *pa interes* nga krushku, dy vite përpara se të niste ndërtimi i pjesës së dytë të godinës, për ta lënë vlerën monetare në ruajtje e *me përfitim* nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet depozitës *me interes*. Subjekti nuk ka provuar qoftë edhe me prova rrethore kalimin e shumës nga xhaxhai, te vjehëri dhe më pas te bashkëshorti i saj. Për gjithë këto aspekte, trupi gjykues vëren se koha kur palët kanë deklaruar huadhënien/marrjen përkon vetëm me momentin kur bashkëshorti i subjektit krijoi depozitat në bankë e, në këtë këndvështrim, kontrata noteriale mund të gjente kuptim si arsye për të krijuar perceptimin e mjaftueshmërisë së burimeve nëpërmjet një huaje.

8.40. Për të ardhurat nga aktiviteti tregtar, Komisionerja Publike pretendon se deklarimet e subjektit dhe personit të lidhur janë kontradiktore dhe nuk e kalojnë nivelin e besueshmërisë, duke rezultuar kështu në pamjaftueshmëri financiare, që vënë në diskutim aplikimin e parimit të proporcionalitetit. Konkretisht: (a) deklarimet e subjektit ndër vite mbi shumën e të ardhurave të përfituara nuk përputhen me vlerën e deklaruar në deklaratën *vetting* apo me aktet e paraqitura gjatë hetimit; (b) kontratën e qirasë, nënshkruar midis bashkëshortit dhe kunatit, subjekti e dorëzoi për herë të parë gjatë hetimit dhe nuk e ka deklaruar si marrëdhënie ndër vite, as në ILDKPKI; (c) të ardhurat e deklaruar janë më të larta se fitimi i konfirmuar nga DRT-ja Fier; (ç) përfitimi i të ardhurave nuk është dokumentuar, qoftë në formën e ndarjes së fitimit apo të qirasë, në këtë kuadër mbetet e paqartë dhe jo e besueshme vlera e të ardhurave nga aktiviteti apo qiraja e përfituar nga bashkëshorti i subjektit, për sa kohë që ai rezulton bashkëpronar i ligjshëm vetëm për gjysmën e pasurisë dhe mund të disponojë lirisht vetëm për këtë pjesë; (d) në vitet 2012 dhe 2013 në pasqyrat financiare nuk është reflektuar zëri i qirasë së ambientit. Analiza e këtyre burimeve afekton pasuritë e paluajtshme dhe shpenzimet e kursimet e deklaruar.

8.41. *Së dyti*, trupi gjykues i Kolegjit korrektoi analizën e Komisionit, duke e gjetur të bazuar logjikën financiare dhe analizën ligjore të Komisioneres Publike. Qasja e Komisionit ka qenë tejet favorizuese, pasi analiza financiare për krijimin e pasurisë nuk është kryer për kohën kur dokumentohet që ajo të jetë bërë funksionale – në fund të vitit 2006²³. Konkretisht, ndonëse dhe sikurse analizuar më sipër²⁴, për normimin ligjor dhe shtrirjen e kontrollit të besueshmërisë për pasurinë në rivlerësimin e subjekteve nga Kolegji dhe Komisioni *edhe* në periudhat në të cilat ata kanë kryer detyra të tjera, Komisioni *ka krijuar* dhe përdorur si kriter përcaktues të shtrirjes në kohë të analizës financiare, tetorin e vitit në të cilin subjekti është emëruar prokurore, dhe zbritur edhe shpenzimet e jetesës *nën* standardin zyrtar për atë vit. Në kushtet që nga të gjitha aktet rezulton se ndërtimi është bërë funksional që në tetor-nëntor 2006, analiza financiare do të ishte objektive për pjesën takuese të subjektit deri në këtë moment në kohë.

²² <https://aksesdrejtesi.al/dokumenta/1689326589Vendim-Mirela-Zavalani.pdf>.

²³ *Sipas aktit të kolaudimit dhe lejes së shfrytëzimit, referuar më sipër që datojnë tetor dhe nëntor 2006.*

²⁴ *Shih paragrafin 8.27 dhe poshtëshënimet nr. 19 e 20.*

Komisioni ka përfshirë të ardhurat e një viti më pas, për një pasuri të paguar një vit më herët, ndonëse gjatë gjithë kësaj periudhe, subjekti ishte gjithsesi pjesë e organeve të drejtësisë dhe prokurorisë që në vitin 1998. Në analizën e kryer në Kolegj, balanca negative që përftohet në momentin e krijimit të pasurisë vetëm për pjesën takuese të subjektit në dhjetor 2006, rezultoi në vlerën (-) 5.103.912 lekë.

8.42. *Së fundmi*, për sa i përket të ardhurave nga aktiviteti privat si burim krijimi i kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti ka riformuluar marrëdhënien konkrete juridike që ka qenë shkas i krijimit të të ardhurave duke e fokusuar atë në një marrëdhënie qiraje dhe jo si të ardhura prej fitimit që gjeneronte biznesi në vetvete. Për të provuar shpjegimet e saj, subjekti dërgoi në Komision disa kontrata qiraje/enfiteoze të lidhura midis bashkëshortit të saj dhe kumatit. Këto kontrata të padeklaruara më parë janë pranuar nga Komisioni. Edhe ky aspekt, në vlerësimin e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit, u bë pjesë e konstatimeve për mungesë besueshmërie të pretendimeve të subjektit për t'iu përshtatur nevojës momentale dhe jo si pasqyrim i së vërtetës, si një përpjekje për të kapërcyer hendekun mes sa rezulton nga aktet dhe çfarë ajo ka deklaruar dhe pohon²⁵. Konkretisht nga aktet në fashikull rezulton se:

(i) *Në deklaratën vetting*, si burime të krijimit të pasurisë objekt analize, subjekti deklaroi edhe të ardhurat nga dyqani [tregtim pjesë këmbimi] në vlerën 7.440.000 lekë. Në deklarinimin e bashkëshortit, ndër të tjera, ai shprehet se: “Pjesa e fitimit nga biznesi është ndarë çdo vit me marrëveshje verbale ndërmjet meje dhe familjes së babait, në 50% ose 40% sipas rastit dhe nevojave, duke qenë marrëdhënie gjinie të afërt (babë e bir)”.

(ii) Drejtoria Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Fier konfirmon se ky biznes, i regjistruar më 15.03.2004, në emër të kumatit të subjektit, ka vijuar aktivitetin deri më 16.12.2015. Në shkresën e datës 17.01.2022, DRT-ja ka konfirmuar së për vitet 2004-2006, personi fizik në emër të kumatit të subjektit ka deklaruar vetëm xhiro në shumat 1.800.000 – 2.300.000 lekë, por jo fitim nga aktiviteti. Për vitet 2008 -- 2015 fitimi varion nga 17.803 lekë deri në 409.902 lekë.

(iii) Në deklaratën e parë, në prill 2004, subjekti deklaroi se ajo dhe bashkëshorti zotërojnë 40% të të ardhurave/fitimit të dyqanit dhe të ardhura vjetore në vlerën 700.000 lekë.

(iv) Në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti deklaroi të ardhura nga dyqani pjesë këmbimi, në masën 1.500.000 lekë, ndërsa DRT-ja Fier konfirmon të ardhurat/xhiro e parashikuar 1.800.000 lekë – tatimi i paguar 54.000 lekë

a) Në deklaratën pas largimit nga detyra si OPGj në vitin 2005, subjekti deklaroi depozitë të krijuar nga të ardhurat nga dyqani i pjesëve të këmbimit. Gjithashtu, deklaroi të ardhurat nga dyqani i pjesëve të këmbimi në 1.200.000 lekë. DRT-ja Fier konfirmon të ardhurat 1.800.846 lekë.

b) Në deklaratën e parë si prokurore të vitit 2007, subjekti i deklaroi të ardhurat nga të ardhura nga dyqani pjesë këmbimi + lubrifikantë në masën 680.000 lekë, ndërsa në deklaratën periodike

²⁵ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 11/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Elisabeta Imeraj (paragrafët 32.11 -32.12): “Në rrethanat që deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga institucionet e rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, fakti që këto veprime nuk kanë lënë gjurmë as në deklarimet e subjektit ndër vite, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, e bën pranimin e pretendimeve të saj në proces të pamundur, shtjelluar gjerësisht nga Kolegji në jurisprudencën e tij”. (Shih edhe vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019, nr. 5/2020, nr. 27/2020, nr. 7/2024, pg. 16.35).

për vitin 2007, subjekti deklaroi të ardhura nga dyqani pjesë këmbimi + lubrifikante mjetesh, në masën 70.000 lekë. DRT-ja Fier konfirmon se tatimi mbi biznesin e vogël është administruar nga pushteti vendor.

c) Në procesverbalin në ILDKPKI, në datën 24.03.2016, pasi subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të paraqesë dokumentacion provues për të ardhurat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore nga ky aktivitet, subjekti shprehet se: *“Nuk kam ndonjë dokumentacion vërtetues, pasi ka qenë biznes i vogël, i cili ka ofruar edhe shërbime të ndryshme për automjete [...] sipas fitimeve është bërë ndarja me marrëveshje midis bashkëshortit dhe familjarëve të tij”*.

d) Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën noteriale të qirasë që mban datën 29.12.2006, ku rezulton se bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e qiradhënësit, zotërues i pjesës prej 1/2 të pjesë takuese të pasurisë objekt kontrate, i ka dhënë me qira vëllait, Person Fizik, dyqanin me sipërfaqe 251 m², me një afat 10-vjeçar, kundrejt vlerës totale bruto prej 3.000.000 lekësh, për të gjithë afatin kohor. Sipas kontratës, vlera e qirasë do të parapaguhej, për vitin e parë 750.000 lekë, për vitin e dytë 500.000 lekë dhe për vitet në vazhdim në dakordësi mes palëve, por jo më pak se 150.000 lekë në vit.

e) Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti depozitoi në Komision kontratën noteriale të qirasë, datë 29.12.2006, me afat 10-vjeçar, lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe vëllait të tij në cilësinë e personit fizik, që konfirmon të ardhura në vlerën 2.660.000 lekë për periudhën 2006 - 2015. Në të njëjtën fazë, subjekti ka sjellë edhe një deklaratë noteriale të vjehrrit, që mban datën 22.11.2022 sipas së cilës deri në momentin e largimit të djalit të tij nga banesa e përbashkët, në vitin 2007, ai ka përfituar të ardhura nga fitimi i aktivitetit tregtar të regjistruar në emër të të vëllait në mënyrë proporcionale, si pjesë e bashkësisë familjare. Pas largimit, bashkëshorti i subjektit, sipas kësaj deklarate, ka përfituar *tërësisht* të ardhurat nga dhënia me qira e ambientit në të cilin ushtrohej aktiviteti, pasuri në bashkëpronësi.

8.43. Për sa më lart, pasi u bind nga shpjegimet e subjektit në prapësim të barrës së provës, Komisioni vlerësoi si alternativë të mundshme disponimin e shumave të plota të përshkruara si kundërshtëpërblim nga kontrata e qirasë, ndonëse vuri re se nuk është provuar legjitimiteti i përfitimit të shumave nga bashkëshorti i subjektit, për shkak se kontrata nuk kishte të shënuar në mënyrë specifike nëse kundërshtëpërblimi ishte për gjithë sipërfaqen apo vetëm për pjesën takuese (1/2 e sipërfaqes). Sipas paragrafit 59 të vendimit të Komisionit, për shkak të marrëdhënieve familjare, mungesa e specifikimit në kontratë për sipërfaqen nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ajo nuk ishte palë në hartimin e kontratës. Me dorëzimin nga subjekti të kontratës noteriale të enftiteozës, Komisioni konkludoi se kjo shumë mund të konsiderohet dhe të merret e plotë në analizën financiare të viteve përkatëse.

8.44. Trupi gjykues i gjeti jobindëse pretendimet e subjektit për të ardhura në formën e qirasë së ambientit në të cilin ushtrohej aktiviteti tregtar, përpos atyre të përfituara nga biznesi, duke pretenduar edhe fitimet në vlerë të plotë, pavarësisht se personi i lidhur/bashkëshorti ishte bashkëpronar në 1/2 e pasurisë. Në deklaratat periodike ndër vite, si dhe në deklaratën *vetting*, subjekti është shprehur për të ardhura nga aktiviteti dhe ka qenë kontradiktore për masën e përfitimit dhe natyrën e të ardhurave që ai përfaqëson. Nga ana tjetër, pretendimet për të ardhura edhe nga qiraja u ngritën për herë të parë gjatë hetimit administrativ, ndërsa disa akte për ta provuar këtë pretendim janë sjellë vetëm pas rezultateve të hetimit në Komision, ndonëse datojnë në vitin 2005. Në vlerësimin e sa më sipër, trupi gjykues i përllogariti të ardhurat sipas akteve zyrtare në pjesën takuese të bashkëshortit në këtë aktivitet, duke përjashtuar pretendimin

për të ardhura nga qiraja. Edhe shpjegimi i subjektit në Komision dhe në Kolegj se kontratën e qirasë bashkëshorti dhe kunati e lidhën në vitin 2005, për shkak se kunatit i kërkohej një adresë biznesi, nënkupton se qëllimi i kësaj marrëdhënie nuk ishte marrja e qirasë. Këto elemente, trupi gjykues i Kolegjit i mbajti në konsideratë në kuadër të besueshmërisë së deklarimeve të subjektit. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

8.45. Sikurse ka konstatuar Komisioni, fillimisht, nuk ka ndonjë dokumentacion të kohës nëpërmjet të cilës bashkëshorti i subjektit dhe i vëllai të kenë qartësuar e strukturuar ndarjen e fitimit nga ky aktivitet. Bashkëshorti i subjektit nuk ka qenë asnjëherë ortak në këtë aktivitet tregtar. Nga aktet ai rezulton bashkëpronar me ½ e aktivitetit ndërsa të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga ndarja e fitimeve, janë edhe më të larta edhe se fitimet totale të referuara në bilancet financiare përgjatë periudhës prill 2004 – 2006. Nga ana tjetër, dy kontratat e huapërdorjes së thjeshtë, lidhur në vitin 2004 dhe kontratë noteriale enfiteoze datë 25.02.2005, janë sjellë për herë të parë në përmbushje të barrës së provës, si shpjegim për fitimin vetëm nga qiradhënia.

8.46. Fillimisht, DRT-ja Fier ka konfirmuar për Komisionin se nuk u gjetën të dhëna lidhur me kontratën e qirasë të vitit 2006, lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe personit fizik “E. Z.” (vëllai i tij). Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti rezulton të ketë marrë një vërtetim të datës 07.05.2004 nga Dega e Tatim-Taksave Fier, sipas së cilit kunati dhe bashkëshorti i subjektit kanë lidhur kontratë qiraje. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka dërguar edhe një kontratë qiraje 10-vjeçare lidhur mes të njëjtëve palë. Nga këto akte dhe ato të përmbledhura e cituara më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimet kontradiktore të subjektit në tërësi e bëjnë të pabesueshme gjendjen financiare të të ardhurave të gjeneruara dhe mbi të gjitha të përfituara nga bashkëshorti i saj. Konkretisht, jo vetëm që vlerat e referuara të fituara nga aktiviteti janë kontradiktore, mes deklaratave periodike dhe deklaratës *vetting* dhe kjo e fundit me vlerat e konfirmuara nga DRT-ja Fier, nga e cila nuk rezulton fitim i gjeneruar për periudhën kohore relevante. Këto vlera, gjithashtu, nuk përputhen as me vlerën e shënuar në kontratën e qirasë 10-vjeçare. Për më tepër, të ardhurat nuk përkojnë me pjesën takuese -- në deklaratën e parë subjekti shprehet se zotëron bashkë me bashkëshortin 40% të këtyre të ardhurave -- që në kohën kur aktiviteti nuk ishte regjistruar, gjeneroi 700.000 lekë në vit.

8.47. Pavarësisht se subjekti kishte kryer deklarime periodike për të ardhurat nga aktiviteti tregtar i kunatit, trupi gjykues vëren se është e pashpjegueshme, përse Komisioni i kërkoi subjektit në pyetësorin nr. 2 të datës 15.11.2022, që të specifikojë shumën e përfituar për çdo vit, që passolli edhe ndryshimin e riartikulimin e fitimeve duke i kanalizuar ato në drejtim të qirasë. Me atë rast, subjekti sqaroi se të ardhurat *nuk* ishin nga fitimi, por nga qiraja, si dhe dorëzoi kontratën noteriale të qirasë së vitit 2006, që kunati dhe personi i lidhur me subjektin kishin nënshkruar.

8.48. Edhe duke abstruar nga momenti i nxjerrjes në dritë të marrëdhënies së qirasë, në kontratën e vitit 2004, nuk shënohet vlera e përfituar. Në kontratën noteriale të enfiteozës së vitit 2005, palët kanë shënuar se vlefshmëria e kontratës do të jetë deri më 31.12.2006 dhe enfiteozmarrësi (kunati i subjektit) do të paguajë bashkëshortin e subjektit brenda muajit prill një shpërblim prej 400.000 lekësh për periudhën e përdorimit të pasurisë. Ndryshe nga sa është shënuar në kontratë, e ndryshe nga pretendimi i subjektit se të ardhurat nga dyqani ishin të ardhura nga qiraja, në deklaratën e largimit nga detyra si OPGj në vitin 2005, subjekti ka shënuar të ardhurat nga dyqani në vlerën 1.200.000 lekë, që nënkupton se deklarimi në

deklaratën periodike nuk përputhet me përcaktimin kontraktual që daton në vitin 2005. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit në seancën dëgjimore se kontrata e qirasë hartuar mes dy vëllezërve kishte për synim plotësimin e dokumentacionit tatimor, duket si i vetmi shpjegim që bën kuptim për arsyen e hartimit të kontratës dhe faktit që ajo daton herët në kohë. Përmbajtja e saj nga ana tjetër paraqet peshë provuese shumë të kufizuar, pasi tërësia e akteve të mësipërme tregon që nëse ka pasur fitime ato do duhet të jenë ndarë sipas pjesëve takuese. Në kushtet që subjekti ka dhënë shumë versione vlerash dhe natyre të marrëdhënies juridike, në kontradiktë me njëra-tjetrën dhe me deklaratimet ndër vite në institucione, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pamundur të reflektojë të ardhura përpos atyre të konfirmuara në vlerë dhe në ligjshmëri nga organet tatimore.

8.49. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin që nga pasqyrat financiare të aktivitetit, depozituar pranë QKB-së, referuar bilanceve të publikuara për vitet 2012 dhe 2013, nuk rezulton të jetë reflektuar shpenzim për qira në zërin “qira ambienti”. Në këndvështrim kontabiliteti, ky aspekt nënkupton që në përllogaritjen e fitimit *neto* të personit fizik nuk ka pasur ndikim shpenzimi i qirasë. Ky fakt nënkupton edhe që marzhi i fitimit të aplikuar nga Komisioni – si interpretim i zgjedhur për vitet 2004-2007, për të cilët nuk ka fitim, por vetëm xhiro, duke pranuar prapësimet e subjektit edhe në këtë rast – në vlerën 35% do të bënte kuptim vetëm nëse nuk ka qira të paguar. Pra, ndërsa nga njëra anë marzhi fillestar i fitimit në 15% i përllogaritur do të kishte kuptim nëse do të evidentohej shpenzim qiraje, marzhi 35% i përllogaritur është pa vend nëse *ka shpenzime qiraje*, pasi fitimi do të ishte më i ulët për shkak të këtij detyrimi. Për këtë arsye, në Kolegj, u vlerësua i pabazuar korrigjimi i kryer nga Komisioni mbi marzhin e fitimit të realizuar nga kunati i subjektit në analizën e të ardhurave familjare në këtë shkak ankimi, që afekton qoftë këtë pasuri, ashtu edhe atë të analizuar në vijim. Në analizën e kryer në Kolegj, marzhi mesatar i fitimit u konsiderua 15% dhe u korrigjua në llogaritjen e fitimeve të personit fizik.

8.50. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit, sipas së cilit subjekti iu njoh një vlerë prej 2.660.000 lekësh nga qiraja e këtij aktiviteti, është i pabazuar dhe i pakuptimtë, pasi deformon deklaratimet e subjektit ndër vite për të ardhurat nga dyqani me pjesë këmbimi²⁶. Për sa më lart, qoftë vlera cilado prej vlerave të referuara, ajo e pranuar nga Komisioni apo vlera totale prej 3.000.000 lekësh, sipas kontratës 10-vjeçare, nuk përputhet me totalin e deklaruar nga subjekti ndër vite -- që është 6.060.000 lekë – dhe as me vlerën e deklaruar në deklaratën *vetting*, që është 7.440.000 lekë. Këto të ardhura nuk duket të kenë lënë gjurmë të kohës nëpërmjet ndonjë akti përpos atyre me natyrë deklarative. Në nivel të përgjithshëm, trupi gjykues vëren se subjekti për aspekte të ndryshme paraqet deklarata noteriale që bien ndesh me aktet e kohës dhe me parashikimet ligjore – sikurse pjesën takuese të pasurisë, arsyetuar më sipër apo pjesën takuese të bashkëshortit në aktivitetin objekt i kësaj analize konkrete apo përfitimim e shumave, sipas pretendimeve të saj, që bien ndesh me aktet e kryqëzuara nga të dhënat zyrtare të administratës tatimore.

8.51. Në Kolegj u korrektoan shpenzimet e jetesës për vitin 2007, sipas shkresës së ILDKPKI-së dhe INSTAT-it. Komisioni rezulton të ketë përllogaritur një mesatare mes viteve 2006 dhe 2008. Duke qenë se ky zë shpenzimesh ka gjetur arsyetim të përsëritur e konsoliduar në

²⁶ Në bazë të legjislacionit tatimor, të ardhurat nga biznesi i personit fizik dhe të ardhurat nga qiraja/enfiteoza janë dy kategori të ndryshme të ardhurash që kanë burime të ndryshme, e për të cilat aplikohet normë e ndryshme tatimore.

vendime të mëparshme të Kolegjit, përfshirë edhe ato që paradatojnë vendimin objekt ankimi të Komisionit²⁷, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të panevojshme të ndalet më tej në këtë aspekt, duke zgjedhur vetëm të konfirmojë atë standard shpenzimesh, ndërsa nga ana tjetër të nënvizojë se edhe kjo qasje e Komisionit ka përbërë favorizim të pabazuar të situatës së subjektit.

8.52. Për sa më lart, trupi gjykues i mbajti në konsideratë kontradiktat e deklarimeve të subjektit përgjatë hetimit administrativ, duke ndryshuar apo shtuar burimet; mospërfundimin e vlerës reale të investimit ndër vite të sipërfaqes; mungesën e saktësisë të kronologjisë për pjesën e investimit të kryer edhe për periudhën gjatë së cilës ajo ka përdorur banesën dhe vjelë edhe të ardhurat që pretendon se ka gjeneruar aktiviteti i vendosur në ndërtesë. Shpjegimet kaotike të dhëna gjatë hetimit administrativ e kanë pamundësuar krijimin e një panorame të qartë për efekt të identifikimit të situatës më afër të vërtetës. *Së fundmi*, përkundër sa pretendon subjekti, paraqitja e shpeshtë e të dhënave të ndryshme nga ato të deklaruara ndër vite, për burimet e krijimit të pasurive, cenojnë besueshmërinë, pasi, sikurse sipërshtetë, si përpjekje që përkon me nevojën e fazës përkatëse në të cilën subjekti është gjendur, ato nuk mund të mos argumentohen si pasqyrim i së vërtetës. Qasja e subjektit nëpërmjet të cilës modifikohen burimet e krijimit të pasurive ka gjetur zbatim edhe në pasurinë që analizohet në vijim. Ishin këto konstatime, ndër të tjera, për të cilat trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti është e pabesueshme në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në të kundërtën e përcaktimit, sipas germës “a” të pikës 1 të neni 59 të ligjit nr. 84/2016.

8.53. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pasi i gjeti të drejta pretendimet e Komisioneres Publike, kreu korrektime të zërave të sipëranalizuar në analizën totale dhe atë të kohës kur janë kryer shpenzimet kundrejt atyre të vitit përkatës, përlllogarit shpenzimet e jetesës sipas standardit zyrtar të INSTAT, si dhe përlllogarit shpenzimet për investimin sipas akteve, për sipërfaqen, kohën e krijimit dhe sipas kostos mesatare të ndërtimit referuar EKB-së. Nga kjo analizë, për ndërtimin e pjesës së dytë të godinës, në vitet 2004 – 2006, subjekti dhe bashkëshorti kishin një mungesë burimesh për pjesën e tyre takuese prej (-) 5.525.986 *lekësh*. Sikurse referuar më sipër, nga kontrolli i analizës financiare për periudhën 2004 – 31.10.2007, balanca negative do të ishte në vlerën (-) 7.230.307 *lekë*²⁸, ndërsa pamundësia për ndërtimin e pjesës së dytë të godinës do të varionte nga (-) 4.300.000 *lekë*²⁹ në 5.100.000 *lekë* vetëm për ndërtimin. Kjo vlerë negative, në ndryshim nga analiza e Komisionit, përjashton trajtimin e subjektit në drejtim të aplikimit të parimit të proporcionalitetit për dhënien e masës disiplinore, pasi është e konsiderueshme. Nëse ky korrektime do të shtrihet edhe te pjesa e parë e investimit – nga prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1996 – 1998 -- ata do të rezultonin, po ashtu, me mungesë të konsiderueshme të burimeve të ligjshme financiare [(-) 3.096.080 *lekë*]. Në kushtet që ky aspekt nuk është shkak ankimi, kjo pjesë e analizës nuk u bë pjesë e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit për efekt të masës disiplinore.

8.54. Për sa më sipër, dhe përpos kontradiktave e mospërputhjeve në deklaratimet e subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së

²⁷ *Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit: (JR) nr. 8, datë 09.03.2021, (JR) nr. 18, datë 08.06.2022, (JR) nr. 43, datë 15.11.2022, (JR) nr. 32, datë 24.07.2023, (JR) nr. 53, datë 15.12.2023 dhe (JR) nr. 43, datë 19.09.2024.*

²⁸ *Referuar e analizuar në vijim, për efekt të krijimit të apartamentit në Tiranë. Kjo shumë lidhet me depozitimin e tërheqjen e vlerës 1.500.000 *lekë* nga depozita bankare në vitin 2004, nga bashkëshorti i subjektit.*

²⁹ *Ndërsa pamundësia për ndërtimin e pjesës së tyre takuese të totalit të godinës do të thellohej në vlerë që varion midis (-) 5.800.000 *lekësh* dhe (-) 6.600.000 *lekësh*.*

burimeve të ligjshme, përcaktuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

B.2. Apartamenti në Tiranë, blerë në vitin 2007

9. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri dhe detajuar si vijon: “*Apartament me sip. 78,6, me vendndodhje në rrugën “{***}”, kontratën noteriale të shitblerjes datë 11.06.2007, nga shoqëria “{***}” ShPK, në shumën 3.144.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”. Pasi hetoi për këtë pasuri dhe pranoi shpjegimet e subjektit, Komisioni konstatoi se mospërputhja midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket burimeve të krijimit të pasurisë në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2007, krahasuar me deklaratën *vetting*, është një pasaktësi, e cila nuk shoqërohet me mungesa financiare. Komisioni përfshiu në mesin e burimeve financiare të disponuara për këtë pasuri të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortit, të ardhura nga qiradhënia e dyqanit, dhuratën nga prindërit dhe tërheqjen e depozitës bankare. Në konkluzion, nga analiza financiare e Komisioni, subjekti kishte një balancë negative prej (-) 70.789 lekësh, për krijimin e pasurisë në datën 11.06.2007. Të gjitha problematikat e tjera u konkluduan pa pasojë për subjektin ose pasaktësi të pashoqëruara me mungesë burimesh të ligjshme. Konkretisht, meqenëse dhurimi nga prindërit e bashkëshortit është deklaruar në deklaratën e vitit 2007, sipas Komisionit, pamjaftueshmëria e burimeve të tyre nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, duke i vlerësuar të ardhurat nga qiraja dhe enfiteoza e dyqanit – analizuar më sipër në detaj – të provuara e me burime të ligjshme, shpjegimet e subjektit u çmuan bindëse për Komisionin. Mosdeklarimi i burimit të krijimit të një depozite në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 nga personi i lidhur, u konsiderua pasaktësi pa përgjegjësi për subjektin e rivlerësimit.

9.1. Komisionerja Publike kërkoi që t’i nënshtrohen kontrollit pasaktësitë e deklarimeve, të cilat krijojnë mospërputhje dhe paqartësi të burimit real të krijimit të pasurisë, dhe në raport me analizën e përgjithshme të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Subjekti nuk arrin nivel të besueshëm, nën dritën e parashikimit nga germa “a” e pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Ankimi fokusohet në: (i) burimet e krijimit të depozitës bankare të personit të lidhur në vlerën 1.950.000 lekë në datën 18.06.2004; dhe (ii) të ardhurat nga supermarketi/dyqani i pjesëve të makinave. Komisionerja Publike pretendon se huaja që vjehri mori nga xhaxhai i subjektit – e analizuar edhe për efekt të pasurisë së sipëranalizuar -- u deklarua vetëm gjatë hetimit administrativ dhe, për më tepër, u deklarua për krijimin e depozitave nga personi i lidhur. Mbetet i paqartë transaksioni dhe përdorimi i kësaj shume, dhënë në formë huaje për krijimin e depozitës bankare në emër të bashkëshortit të subjektit, duke tejkaluar qëllimin e huas.

9.2. Gjatë seancës gjyqësore publike në Kolegj, subjekti potencoi se ka deklaruar saktë burimet e krijimit të pasurisë në deklaratën para fillimit të detyrës. Për sa i përket *depozitës* bankare të krijuar nga bashkëshorti në vitin 2004, aktet provojnë vijimësi financiare para dhe pas krijimit të saj, që nënkupton mundësinë e krijimit të të ardhurave me burime të ligjshme. Origjina e depozitës bankare të bashkëshortit është e dokumentuar dhe pjesërisht është ushqyer nga huaja e marrë nga vjehri xhaxhait të saj në dy këste, deklaruar në mënyrë transparente. Kërkesa e Komisioneres Publike për rivlerësim të këtij zëri nuk ngrihet mbi një dyshim të arsyeshëm dhe as në standardin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencën e Kolegjit se pasaktësitë e pashoqëruara me mungesë burimesh nuk përbëjnë shkak për penalizim. Moscitimi “analitik”

i burimit të depozitës në deklaratën periodike për vitin 2004 përbën vetëm pasaktësi formale. Fakti që analiza financiare e Komisionit ka rezultuar me suficit, nënkupton se depozita rrjedh nga burime të ligjshme. Marrëdhënia e huas mes vjehrrit dhe një pale të tretë nuk mund të prodhojë pasoja penalizuese ndaj saj. *Së fundmi*, për të ardhurat nga aktiviteti privat/qiraja nuk duhen përgjysmuar, pasi nuk mbështeten nga aktet. Përfitimi i të ardhurave provohet nga deklaratat periodike vjetore dhe nga aktet e tjera. Tërheqja bankare e vitit 2021, për një vlerë që referohet si tatim në burim, nuk përbën pranim të detyrimit tatimor dhe as provë të mungesës së burimeve të ligjshme. Të ardhurat nga qiraja duhen konsideruar *neto*.

9.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit, vëren se edhe për këtë pasuri subjekti ka qenë kontradiktore në lidhje me burimet e krijimit dhe është përpjekur t'i ndryshojë ato gjatë procesit të rivlerësimit, duke prezantuar elemente mungese besueshmërie. Në përfundim të kontrollit të vendimit të Komisionit, bazuar në shkaqet e ankimit, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti të bazuara pretendimet e Komisioneres Publike. Vlerësimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

9.4. Deklarimet e subjektit për burimet e krijimit të pasurisë kanë ndryshime mes tyre, nëse krahasohen deklarata e vitit 2007, procesverbali në ILDKPKI në mars 2016 dhe deklarata *vetting*. Konkretisht:

a) Në deklaratën *vetting*, janë deklaruar si burim: (i) *kursimet* ndër vite nga paga si OPGJ; (ii) *bursa* nga Shkolla e Magjistraturës; (iii) të ardhurat nga *paga* e bashkëshortit; dhe (iv) të ardhurat nga *dyqani* tregtim-pjesë këmbimi;

b) Në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokurore, në vitin 2007, si burime të krijimit të pasurisë, subjekti ka specifikuar: (i) 10.000.000 lekë (të vjetra) kursime; (ii) 15.000.000 lekë (të vjetra) të ardhura nga dyqani i tregtimit të pjesëve të makinave; dhe (iii) 7.000.000 lekë (të vjetra) dhuratë nga prindërit e bashkëshortit. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë 9.000 USD dhe 4.500 euro;

c) Në deklaratën periodike për vitin 2004, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar krijimin e *depozitës bankare* në datën 18.06.2004, por nuk ka specifikuar burimin e të ardhurave që kanë ushqyer/shërbyer për këtë qëllim. Nga ana tjetër, pyetur në mënyrë specifike në ILDKPKI, në vitin 2016, për këtë pasuri, subjekti ka referuar si burime: (i) të ardhurat nga paga; dhe (ii) aktiviteti tregtar në Patos;

d) Në pyetësin nr. 2, në Komision, për mospërputhjet në burimet e krijimit të apartamentit objekt analize, mes deklaratës *vetting* dhe asaj përpara fillimit të detyrës si prokurore, subjekti u shpreh se të ardhurat kanë burime *kursimet* nga pagat dhe fitimi nga *aktiviteti* ekonomik: (i) kursimet nga pagat janë përdorur realisht në shumën 1.700.000 lekë dhe jo 1.000.000 lekë, siç deklaroi në deklaratën e vitit 2007; (ii) të ardhurat nga supermarketi/tregtimi i pjesëve të makinave, në shumën 1.500.000 lekë, përbëheshin nga dhurata nga prindërit e bashkëshortit 700.000 lekë dhe 800.000 lekë nga aktiviteti tregtar; (iii) depozita 1.950.000 lekë është ushqyer me 450.000 lekë janë nga kursimet e familjes së saj dhe 1.500.000 lekë, nga huaja që vjehri mori nga xhaxhai i subjektit në datën 03.06.2004, për ndërtimin e pjesës së dytë të godinës në Patos, administruar/në ruajtje nga bashkëshorti si depozitë bankare, meqenëse vjehri nuk zotëronte llogari bankare në atë kohë. Bashkëshorti ia ka kthyer shumën babait në vitin 2005, nëpërmjet dy tërheqjeve nga një depozitë e mëparshme, si dhe disa kursime të disponuara në *cash*, duke bërë që depozita e çelur në vitin 2004, të vijonte të qëndronte e investuar në Tirana

Bank, deri në janar të vitit 2006. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti depozitoi disa deklarata noteriale³⁰.

9.5. Nga aktet e mësipërme rezulton se, ndërsa në deklaratën *vetting* burimet janë pagat dhe aktiviteti privat, në vitin 2007 subjekti ka referuar edhe *dhuratë* nga prindërit e bashkëshortit. Këto dy akte bien ndesh me njëra-tjetrën. Po ashtu, në vijim, Komisioni i ka mundësuar dhe ka pranuar nëpërmjet pyetjeve specifike që subjekti, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 të shtonte burime të tjera. E thënë ndryshe, ajo që subjekti e cilëson si “kanalizim” ka prodhuar shtimin e burimeve të krijimit të pasurisë në kushtet që tashmë subjekti ka deklaruar për herë të parë edhe huan që xhaxhai i saj i ka dhënë vjehrrit – që në thelb ka ushqyer depozitën bankare të bashkëshortit. Sikurse arsyetuar edhe më sipër në paragrafin 8.39, një sërë rrethanash që lidhen me ushqimin e depozitës nga paratë e huas janë alogjike e pa sens ekonomik në kushtet që koha kur është marrë huaja nuk përkon me nevojat e vjehrrit e, mbi të gjitha, pretendohet që huadhënësi ka mundësuar që huamarrësi të fitojë edhe interesa nga paratë e tij, pa zgjedhur ta përfitojë vetë këtë vlerë financiare. Ndërkohë, subjekti e bashkëshorti ishin të punësuar dhe subjekti nuk ka referuar situatë nguti e vështirësie financiare që e bëri të nevojshme këtë dinamikë veprimesh. Sikurse arsyetuar më sipër, në kushtet që qëllimi i këtyre huave pretendohet ndërtimi i pjesës së dytë të godinës në Patos dhe leja u mor vetëm në maj të vitit 2004, kalimi i pjesës së parë të huas që në vitin 2002³¹, dy vite përpara miratimit të lejes së ndërtimit, përforcon bindjen se veprimet nuk përkojnë me qëllimin për të cilin ato referohen. *Së fundmi*, subjekti pretendon se gjatë periudhës së ndërtimit të pjesës së dytë të godinës i ka kthyer vjehrrit vlerën që i mori nga huaja e parë dhe nuk është e qartë, përse vjehri i subjektit duhet të merrte edhe një hua të dytë, që bashkëshorti i subjektit e depozitoi në llogarinë bankare në datën 18.06.2004. Marrja e pjesës së dytë të kësaj huaje me qëllim ndërtimin e godinës që leja iu miratua dy javë para marrjes së saj, ndërkohë që kjo hua u depozitua menjëherë në llogari nga bashkëshorti i subjektit, mbetet e paqartë dhe shpjegimet e subjektit që ishte kjo hua një ndër burimet e depozitës, nuk janë të besueshme.

9.6. Për sa më sipër, nga aktet rezulton qartë që subjekti ka shtuar burimet e krijimit të pasurisë gjatë procesit, përpos mospërputhjes fillestare mes deklaratimit në vitin 2007 dhe në vitin 2017 [në deklaratën *vetting*]. Kjo shtesë burimesh gjatë hetimit administrativ është mundësuar dhe pranuar nga Komisioni. E parë në terma kohorë, subjekti ka shtuar burimet e krijimit të pasurisë në fundvitin 2022, mbi pesë (5) vjet pasi ishte hartuar deklarata *vetting*, ndërsa Komisioni kishte rivlerësuar qindra subjekte rivlerësimi³², problematikat e të cilëve pasqyroheshin gjerësisht në burime të hapura. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndërkohë që huamarrja në fjalë ishte veprim i viteve 2002 dhe 2004, dokumentuar në vitin 2005, për herë të parë ajo gjeti pasqyrim si burim që ka ushqyer depozitën vetëm në pyetësorë. Subjekti nuk ka referuar huan as edhe në përgjigje të pyetjes konkrete për këtë pasuri në mars 2016 në ILDKPKI, kur i është dhënë mundësia të jepte shpjegime tetë vite më afër në kohë sesa pyetësori nr. 2, i Komisionit.

³⁰ Subjekti ka sjellë një deklaratë noteriale të prindërve të bashkëshortit ku ata shprehen se dhurimi 700.000 lekë kishte si burim kursimet e tyre ndër vite, një deklaratë noteriale të datës 26.11.2005, në të cilën vjehri i subjektit, ka deklaruar se ka marrë hua nga xhaxhai i subjektit vlerën prej 3.000.000 lekësh, përkatësisht 1.500.000 lekë në datë 26.10.2002 dhe 1.500.000 lekë në 03.06.2004. Subjekti depozitoi edhe një kontratë shitje pasurie të paluajtshme që mban datën 05.03.2002, nëpërmjet të cilës huadhënësi ka prej tij, nga shitja e së cilës ka përfituar të ardhura në masën 3.900.000 lekë, që mbulon vlerën e huazuar.

³¹ Pjesa e dytë e huas pretendohet e marrë më 03.06.2004, rreth dy javë pas miratimit të lejes së ndërtimit.

³² Deri në qershor 2022, Komisioni kishte kryer procesin për 535 subjekte rivlerësimi dhe shkarkuar 200 mes tyre. <https://abcnews.al/5-vjet-nga-krijimi-kpk-ben-bilancin-535-vendime-te-marra-200-shkarkime/>

Për sa më sipër, dhe në kushtet që nuk ka as edhe indicie nëpërmjet ndonjë akti të kohës që të provojë lidhjen midis vlerave që bashkëshorti saj depozitoi në bankë, me vlerat e marra hua nga vjehri³³ prej xhaxhait të subjektit, këto shpjegime të dhëna për herë të parë në vitin 2022 vlerësohen të pabesueshme.

9.7. Sikurse arsyetuar më sipër, mosdeklarimi ndër vite i të ardhurave nga qiraja, si burim tjetër për krijimin e pasurisë, së bashku me elemente të tjera – sasia e të ardhurave të deklaruara krahasuar me ato që konfirmohen dhe pjesa takuese, më së paku – provuar nga dokumentet zyrtare që janë në harmoni me njëra-tjetrën, u vlerësuan në tërësi si aspekte që krijojnë bindjen se të ardhurat nga qiraja e ndërtesës, pretenduar të fituara tërësisht nga bashkëshorti i subjektit, në thelb janë pasqyrim i nevojës së subjektit për të përmirësuar situatën financiare që rezultonte. Pretendimet e subjektit për burimet janë kontradiktore me aktet. Për pasojë, edhe për këtë pasuri, subjekti vlerësohet se nuk arriti nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, sikurse parashikohet nga germa “a” e pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

9.8. Në vijim, analiza e kryer në Kolegj u fokusua në mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë sipas deklaratës *vetting* dhe shpenzimeve e kursimeve të tjera të kohës kur është blerë apartamenti. Në kushtet që të ardhurat nga aktiviteti ekonomik -- supermarketi/njësia tregtare -- që janë deklaruar si burim krijimi për pasuritë e paluajtshme dhe kursimet e shpenzimet e kryera -- janë trajtuar më sipër, për arsyet për të cilat nuk mund të përfshihen në analizën e burimeve financiare të disponuara nga subjekti e bashkëshorti për këtë pasuri, por edhe për sa i përket pasurisë së parë, në këtë rubrikë, trupi gjykues e gjen të panevojshme të ndalet sërish në këtë zë, përveç konfirmimit që shkaqet e ankimit u gjetën të bazuara ndërsa pretendimet e subjektit për këto të ardhura janë jobindëse. Aspekti tjetër i këtij shkak ankimi, depozita në vlerën 1.950.000 lekë, është analizuar pjesërisht për të sjellë në pah aspekte kontradiktore të pretendimeve të subjektit që e bëjnë të pabesueshme situatën e paraqitur prej saj. Për rrjedhojë, analiza do të ndalet vetëm në aspekte të kësaj marrëdhënieje që kanë relevancë për depozitën e që nuk janë trajtuar.

9.9. Përpos sa është arsyetuar më sipër, për huan nga xhaxhai i subjektit vjehrit të saj, në këtë pjesë të arsyetimit, trupi gjykues analizoi aspektet e efektit financiar që do të kishte disponimi i kësaj shume nga huamarrësi në funksion të financimit të dhurimit të shumës 700.000 lekë subjektit dhe bashkëshortit, për blerjen e apartamentit. Edhe parë në këtë aspekt, panorama faktike që prezanton subjekti gjatë procesit rezulton jobindëse. Subjekti pretendon një skenar në të cilin në vitin 2004 u mor pjesa e dytë e huas nga xhaxhai i saj, megjithëse gjysma e parë qëndronte e *ngurtësuar* si depozitë e bashkëshortit të saj nga e cila ai vilte edhe interesa. Po ashtu, subjekti paraqet një situatë, sipas së cilës vjehri i saj krijoi edhe të ardhura të mjaftueshme për të shlyer në datën 26.11.2005 një pjesë të huas së parë, pa e përdorur atë, ndërkohë që në janar 2006, personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti e tërhoqi huan/depozitën dhe interesat. Përpos sa më sipër, në vitin 2007, vjehri i subjektit *zgjodhi edhe të mos shlyente huan e marrë*, por t'i dhuronte personit të lidhur dhe subjektit edhe 700.000 lekë, për të blerë

³³ Në datën e nënshkrimit të deklaratës noteriale 26.11.2005, vjehri i subjektit ka deklaruar se i ktheu huadhënësit vlerën 300.000 lekë, dhe pjesën tjetër do t'ia kthejë në vijim. Konfirmimin e kthimit të huas, palët e deklaruan me deklaratën noteriale të datës 27.03.2012, sipas së cilës shuma prej 3.000.000 lekësh, u kthye në kohë të ndryshme. Ndërsa, në deklaratën noteriale të hartuar dhe dorëzuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, datë 19.01.2023, vjehri i subjektit deklaroi se 300.000 lekë ia ktheu huadhënësit në datën 26.11.2005, dhe pjesën tjetër 2.700.000 lekë e shleu duke u nisur nga viti 2008 deri në datën 27.03.2012, sipas mundësisë së kursimit.

apartamentin në Tiranë. Rrethanat faktike të mësipërme, të prezantuara nga subjekti, u vlerësuan si aspekte që bien ndesh me njëra-tjetrën e me logjikën ekonomike.

9.10. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit kreu analizën financiare të krijimit të depozitës, për shkak të efektit që ajo ka në krijimin e pasurisë objekt analize. Ndryshe nga Komisioni, në analizën e kryer në Kolegj, nuk u përfshi në mesin e burimeve të ligjshme të periudhës në fjalë shuma 1.500.000 lekë e huas së analizuar më sipër. Dokumentacioni bankar konfirmon që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar shumën 1.950.000 lekë [në Tirana Bank] në datën 18.06.2004. Depozita është tërhequr plotësisht bashkë me një pjesë të interesave të fituara, në tre transaksione³⁴ gjatë vitit 2006. Në të njëjtën linjë me Komisionin, edhe në analizën e kryer në Kolegj, krijimi i depozitës është përlllogaritur kundrejt të ardhurave të periudhës 01.01.2004 – 18.06.2004, në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* jashtë sistemit bankar në deklaratën për vitin 2003. Nga analiza e kryer mbi këto kritere e të dhëna, në Kolegj, subjekti dhe bashkëshorti rezultojnë në *pamundësi* financiare prej (-) 1.423.679 lekësh për krijimin e kësaj depozite me të ardhurat e periudhës 01.01.2004 – 18.06.2004.

9.11. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit në Kolegj, u konstatua se subjekti dhe bashkëshorti i saj ishin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, pasi ata rezultojnë me një balancë negative në vlerën (-) 2.421.448 lekë, për blerjen e apartamentit në vitin 2007. Në përmbledhje të sa më sipër, në kontrollin e analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, edhe për vlerën që përfaqëson variantin më garantist, sipas arsyetimit të potencuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare, duke qenë kështu në kushtet e parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në total, balancat negative të konstatuara për krijimin e pasurisë së parë dhe të dytë, së bashku me atë që rezulton nga analiza financiare, arrijnë në një vlerë prej mbi (-) 5.000.000 lekësh, e cila përjashton mundësinë e zbatimit të parimit të proporcionalitetit në rastin e subjektit të rivlerësimit.

B.3. Për disa transaksione financiare të bashkëshortit të subjektit përgjatë viteve 2009 – 2013, në vlerën 59.020 USD

10. Komisionerja Publike pretendon se subjekti nuk u pyet për qëllimin apo burimin e shumave të transferuara në shumën dhe kohën e sipër referuar, duke potencuar se përfshirja e tyre do të ndikonte drejtpërsëdrejti në analizën financiare dhe passillte pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme, me ndikim domethënës në analizën financiare të viteve respektive. Pavarësisht se këto transaksione konfirmohen nga aktet bankare, të kryera mes bashkëshortit të subjektit me vëllanë, Komisioni nuk ka hetuar rreth tyre. Në fjalën përfundimtare, Drejtuesi i SPAK-ut u shpreh se mbeti minimalisht e provuar që subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar veprimet bankare, ndonëse subjekte deklaruese sipas ligjit nr. 9049/2003. Në gjendjen që janë aktet, përfshirja e bashkëshortit të subjektit në marrëdhënien kontraktuale mes vëllait dhe një pale të tretë, në kushtet që huadhënësi deklarohet të jetë i afërm me të dy vëllezërit, sipas tij, këto problematika duhen vlerësuar si sjellje që cenon besimin e publikut te drejtësia.

10.1. Subjekti kundërshtoi kërkimin e Komisioneres Publike, duke u shprehur se fondet e kaluara nëpërmjet sistemit bankar janë të kunatit të saj dhe kanë për origjinë marrëdhënie

³⁴ Vlera totale e tërhequr gjatë vitit 2006 është 1.980.000 lekë [përkatësisht: 860.000 lekë tërhequr në 23.01.2006, 620.000 lekë tërhequr në 07.04.2006 dhe 500.000 lekë tërhequr në 01.09.2006].

huamarrjeje mes tij dhe kushërinjve që kanë një aktivitet privat. Sipas saj, roli i bashkëshortit ka qenë i kufizuar në ndihmesën e dhënë për të vëllanë. Subjekti theksoi edhe që nuk i kishte kaluar barra e provës gjatë hetimit administrativ në Komision dhe solli e kërkoi të pranohen në cilësinë e provës disa akte, të përmbledhura në hyrje të këtij vendimi.

10.2. Trupi gjykues i Kolegjit i pranoi aktet e sjella në cilësinë e provës dhe vlerësoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për këto *transferta bankare* ndërkombëtare, në vlerën në total prej 59.020 USD, në favor të kumatit të saj nga personi i lidhur/bashkëshorti, nuk ishin bindëse. Këto veprime u vlerësuan nga trupi gjykues i Kolegjit se ndikojnë në besueshmërinë e kriterit të kontrollit të pasurisë dhe, si të tilla, do të konsiderohen brenda këtij kriteri, në ndryshim nga sa u kërkua prej Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Në përmbledhje, sikurse arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një mungese të burimeve të ligjshme për krijimin e dy pasurive që përcakton edhe zgjidhjen e çështjes. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

10.3. Nga aktet në fashikujt e administruar në Kolegj, konstatohen se në llogarinë në monedhën USD në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit³⁵, për periudhën 26.01.2009 - 23.10.2013, janë kryer disa depozitime *cash* që variojnë nga 550 USD në 10.000 USD. Në total ato arrijnë shumën prej 59.020 USD. Këto shuma janë transferuar në favor të vëllait të tij, me përshkrime të ndryshme³⁶ dhe përbëjnë transferta kryesisht brenda vendit. Në kushtet që të gjitha të dhënat bankare janë pjesë e dosjes së Komisionit, ato do të duhet të ishin pasqyruar në një zë të veçantë në analizën financiare, në seksionin e shpenzimeve, meqenëse në këndvështrim të flukseve monetare të një ekonomie familjare, transfertat paraqiten me kah të njëjtë me shpenzimet.

10.4. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pakuptimtë pretendimin e subjektit, për arsyet për të cilat në këtë dinamikë u përfshi bashkëshorti i saj në kushtet që edhe i vëllai ka të njëjtën lidhje gjinore me personat që argumentohen si financuesit e shumave. Për më tepër, fakti që dërgesat janë kryer nëpërmjet depozitimeve në *cash* të bashkëshortit të subjektit dhe kanë destinacion brenda vendit, e zbeh besueshmërinë për variantin e fakteve të pretenduar prej saj. Në kushtet që bashkëshorti i subjektit ka depozituar dhe përdorur llogarinë e tij bankare për të lëvizur shuma në një total të konsiderueshëm [përreth 60.000 USD] në një hark kohor disaveqar, nga njëra anë, dhe që ndërmjetësimi nëpërmjet i marrë përsipër prej tij nuk rezultoi të ishte një event i izoluar në kohë, dhe as u provua përpjekje e palëve të treta, për ta marrë përsipër në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin në praktikë të kësaj marrëdhënieje, nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se parashtrohet një raport marrëdhëniesh alogjike. Fakti që subjekti e bashkëshorti nuk kanë përmbushur detyrimin për të deklaruar, sipas ligjit nr. 9049/2003 këto veprime financiare, *së fundmi*, u bë pjesë e analizës integrale të kryer në Kolegj, që shkon në drejtim të konstatimit që subjekti është përgjithësisht e pabesueshme në vlerësimin e pasurisë, parë edhe në këtë kontekst. Për rrjedhojë, arsyetimi i parashtruar nga Drejtuesi i SPAK-ut është i bazuar, ndonëse në Kolegj u analizua si pjesë e kontrollit të pasurisë.

11. Në përfundim, në analizë të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk është e besueshme në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas një leximi *a contrario* të gurmës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për të

³⁵ Sipas shkresës të datës 16.06.2021 të Raiffeisen Bank.

³⁶ *Transfertat shoqërohen me përshkrimet: “Detyrime”, “detyrime për vëllain”, “transferim fondi”, “transfertë personale”, “dhuratë”.*

krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të tjera. Në këto kushte, pas reflektimit të konkluzioneve të sipërcituara, nën dritën e pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm. Për këto arsye, vendimi nr. 673, datë 15.06.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, është i pambështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet dhe subjekti të shkarkohet nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 673, datë 15.06.2023 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 24.10.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi